

BIBLIOTEKA


E

92

D.63

GJIROKASTER

SHTETIT



PAL DOÇI

NJE
NGA
TE TETET

92

S

D. 63

PAL DOÇI


R

NJË NGA TË TETËT

*Skicë jetëshkrimi e Heroit të Popullit
dëshmorit Xheladin Beqiri (Karadaku)*

34807

~~56244~~



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJË NGA TË TETËT

Dimri i ashpër po venitej. Herë-herë bënin dhe ditë të ngrohta me diell. Por në malet kreshnike të Labërisë çdo ditë e më me forcë kishte nisur të vezullonte drita e partisë. Kjo i ra në sy menjëherë Xheladinit. Puna në tokën e Kaçupajve, në Stok të Nivicës, nuk po i shkonte më për shtat. Ndonëse ishte hyzmeqar, ai e ndjente fort peshën e rëndë të jetës së katundarit në ato vite pushtimi e zie kombëtare, e ndjente se kishte të drejtë të gëzonte jetën e një labi të lirë dhe të punonte si të ishte në shtëpinë e vet. I kujtoheshin fëminia e rinia në Kosovë e në Rrafsh të Dukagjinit, ku sunduesit serbë e malazezë kishin kurdisur kundër vendësve shqiptarë gjithfarë poshtërsishë: vrasje pas shpine në pusi, përdhunime, zhdukje familjesh të tëra dhe dëbime prej trojeve të tyre amëtare shekullore. Gjatë një udhëtimit që kishte bërë, në janar të vitit 1942, deri te disa miq të vet në Fier, Durrës, Shijak e Tiranë, Xheladini kishte parë se edhe fashistët italianë po nguleshin në tokat më të mira shqiptare. Kjo ja kishte shtuar shumë urrejtjen për pushtuesin dhe e ndjente si një detyrë të dorës së parë, si nevojë jete, si shtytje të brendshme luftën kundër tij. Nga bisedat e

komunistëve me popullin Xheladini kishte kuptuar gartë se çlirimi kombëtar mund të arrihej vetëm nëpërmjet luftës së armatosur kundër pushtuesit. Këtë e kishte ngulitur thellë në zemër. «Me u ba me komunistët, s'ka rrugë tjetër», mendonte me vete Xheladini. Këtë ua thoshte haptazi disa shokëve të vet. E Xheladini ishte njeri i veprimit. Atë që synonte, përpiqej ta vinte në jetë. Kështu ju përvesh punës për të krijuar lidhjet, për të nisur rrugën e luftës. Nëpërmjet njerëzve të lëvizjes nacionalçlirimtare në fshat kërkoi të takohet me partizanët.

Në muajin mars të vitit 1942, kur pranvera ende nuk i kishte veshur me petkun e saj të gjelbër ato anë, Xheladin Beqiri, i shoqëruar nga Ago Çela, shkoi te partizanët kurveleshas, që gjendeshin në malin e Kantait, përmbi Gusmar.

Kështu shtatë burrave, shtatë luftëtarëve të parë të lirisë në këtë krahinë, ju shtua edhe një, i teti, «Karadaku». Me këtë emër e pagëzuan ata Xheladin Beqirin në kujtim të maleve kreshnike të anës verilindore të vendlindjes së tij, të heroizmit të popullit të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, që shekuj me rradhë kishte derdhur gjakun pa kursim për liri e pavarësi.

Pas disa ditësh, më 1 prill 1942, njësitë gueril me këta të tetë luftëtarë mori emrin «Çeta e parë partizane e Kurveleshit».



Xheladin Beqiri (Karadaku)

NËPËR DALLGËT E JETËS

Karadaku ishte njeri i punës, i veprimit. Ai fliste rrallë, nuk i pëlqenin llafet, e sidomos mburrjet i urrente me shpirt. Kishte trup të bëshëm, mustaqe të zeza me majë pak si të kuqerremtë, sy të kaltër të mëdhenj. Që në pamjen e parë të linte mbresën e një trimi, nga ata që, siç thotë populli, e bëjnë vdekjen si me le. Në fytyrën e tij kuqaloshë e të qeshur pasqyrohej një botë e brendshme, sa fisnike aq edhe burrërore. Ai shpesh humbiste në kujtime. Herë pas here i përfytyrohej e kaluara e tij e hidhur dhe e trishtuar. Nuk i shlyheshin nga mendja pamjet e llahtarshme që i kishte rastisur të shikonte në Kosovë e në Rrafsh të Dukagjinit. Por Karadaku ishte njeri i fortë, i ndrydhte kujtimet e hidhura përbrenda vetes, nuk donte që të keqen ta ndante me të tjerët.

* * *

Xheladini ishte djali i dytë i Haxhi Beqirit nga fshatrat e krahinës së Gjilanit. Ishte fëmijë kur shpërtheu Lufta ballkanike. I ati, për t'u shpëtuar

ndjekjeve të ushtrisë shoviniste serbe, mori malet. Një mëngjez herët, një bandë xhandarësh, të prirë nga kolonë serbë, u fut befaz në shtëpi. Xheladini po flinte i qetë, po bënte gjumin e mëngjezit. Disa zëra të huaj ja prishën gjumin. Kur hapi sytë pa se disa xhandarë i kishin drejtuar grykat e pushkëve me bajoneta të mbërthyera. Te vatra rrinte e ëma. Si të mos kishte njeri në dhomë fare, ajo po i frynte e qetë e pa u tronditur zjarrit. Disa xhandarë po kontrollonin nëpër skuta e hatulla.

— Shikoni se mos është fshehur në nevojtoje,
— urdhëroi me zë të çjerrë oficeri.

— Eh, po mund ta ketë zotnia jote zakon me u mshehun atje, po burri em nuk asht asish që mshihet. Kur i vijnë njerëz në shtëpi, në qofshin miq i pret me kafe e bukë, në qofshin anmiq i pret me pushkë qysh larg.

— Tash e fusim ne edhe burrin tand atje në birucë, si shumë e shumë të tjerë, — ju gërmush oficeri.

Ajo, si pa të keq, pa i përfillur fare kërcënimet e oficerit, nxiti zjarrin e vuri xhezven e vogël të kafesë, atë që vinte vetëm për vete.

Xhandarët kryen kontrollin e pasi nuk gjetën atë që kërkonin, për të zhdukur gjurmët e grabitjes, të plaçkave që rrëmbyen, i propozuan oficerit ta digjin shtëpinë.

— Një truall pisi më pak, — i thanë ata.

— Le t'i dalë flaka në kulm të pullazit, — urdhëroi oficeri tërë inat.

Prishën një mullar bari të thatë dhe e futën brenda. E lagën me vajguri. Punë sekondash. Flakët e përpinë shtëpinë. Gruaja me dy fëmijë, Xheladi-

nin 8 vjeç e tjetrin në djep, i hipi kaloshinit. Kali ishte egërsuar shumë, frante, përpiqte këmbët e nuk donte të ecte. Pasi i kthyen shpinën shtëpisë, së cilës tanimë i ishte shembur çatia, dolën në rrugë të madhe e po ecnin drejt perëndimit, drejt Rrafshit të Dukagjinit. Diku atje, afër Gjakovës, ajo kishte gjakun e gjininë e vet.

U vendos në Gjakovë, në lagjen Mulla Isufi. Kjo ishte një lagje periferie e banohej kryesisht nga Malësorë. Këtu kishte shtëpinë edhe Bajram Curri.

Si muhaxhir, duke mos pasur me se të jetonin, u morën me punë nga më të ndryshmet. Vëllai i madh mori zanat — gunaxhi, e shkonte andej-këndej për të qepur petka kombëtare të leshta. Vëllai i tretë ja hyri punës së vështirë e jo të vazhdueshme të druvarit. Xheladini punonte në bujqësi, si argat te familjet e pasura.

— Para se të vishen e të ngrohen, — u thoshte ai vëllezërve me shaka — njerëzit duan të hanë, duan bukë. Pra unë me bukën e të tjerëve do të mundohem të nxjerr bukën time.

Ngjarjet historike u zhvilluan me shpejtësi. Xheladini, ndonëse mjaft i ri, që ndër të parët që ju përgjegj thirrjes së Komitetit kombëtar për mbrojtjen e Kosovës e u fut pa lëkundje në radhët e një formacioni të rinisë kosovare, të cilin Komiteti e vendosi në Krumë. Aty Xheladini qëndroi më se dy vjet. Gjatë kësaj kohe ai fitoi mjaft njohuri ushtarake dhe mësoi pak shkrim e këndim. Pas dështimit të Revolucionit të Qershorit filloi ndjekja e kosovarëve partizanë të Hasan Prishtinës e të Bajram Currit. Xheladinit i propozuan bejlerët e familjes Kryeziu që të vishej xhandar. Ai nuk pra-

noi. Për t'i shpëtuar arrestimit, pas janarit të vitit 1925, duke u endur nga njera krahinë në tjetrën, punoi si argat.

Në Kosovë e në Rrafsh të Dukagjinit vërshuan me shumicë kolonët sërbo-malazez. Çështja e tokave dhe e ujit në mes të vendasve shqiptarë dhe kolonëve u acarua shumë. Në këtë kohë Xheladini ishte burrë i pjekur dhe e shihte me keqardhje këtë acarim të gjendjes. Nisi të vriste mendjen si të dilej nga kjo rrugë pa krye, po nuk i jepte dot anë. «Arbania e Vogël», e vetmja shpresë që kishte, nuk qe më. Të hidhej përtej, në Shqipërinë e pavarur, ngurronte. I kujtohej dhjetori i vitit 1924. Bandat e serbomëdhenjve e të bjellogardistëve, që i kishte dëbuar nga atdheu i vet fshesa e Revolucionit të Tetorit, kaluan kufirin e shtypën me zjarr e me hekur demokracinë në Shqipëri, sollën satrapin në Tiranë. Në mes shokësh ai shfrynte dufin e tij kundër tiranit: «Edhe Zogu si këta është, nuk e çuan kot të sundojë atje. E çfarë sundimi, se? Vrau Bajram Currin, shpërndau e shfarosi partizanët e tij, la të vdesë për një copë bukë Shote Galicën! Ja kush është Zogu. E ç'mund të presësh prej tij?»

Një ditë në pazar të Gjakovës bleu pak duhan. Ai e pinte shumë duhanin «për të mbytur vrerin me helm», — si thoshte shpesh ai. Një polic e kapi gjoja për kontrabandë dhe e çoi në polici. Atje e mbajtën disa orë në një birucë, pastaj e mori në pyetje një oficer i moshuar, barkmadh. Ishte majur duke grabitur pasuritë e shqiptarëve që shpërngulte nga trojet. Me ta parë këtë oficer, Xheladini u sëkëlldis shumë. Si të binte rrufeja, ju drodh krejt trupi, ndërsa djersë të ftohta ja mbuluan fytyrën,

mornica të forta ja përshkuan tërë shtatin. Por i mblodhi forcat. U përmbajt. E mbylli në zemër pezmin dhe qëndroi i qetë e krenar. Nuk ishte nga ata që ligshohen.

— Pse merresh me kontrabandë, or pis shif-tar? — shfryu oficeri me inat e u mat t'i binte me flakureshë. Xheladini qëndroi drejt, pa i lëvizur as qerpiku. Shikonte ashpër oficerin e kujtohej se ku e kishte parë atë fytyrë sa të egër aq edhe të shëmtuar.

Pas shumë kacafytjesh me fjalë Xheladini pagoi njëqind dinarë gjobë, me një fjalë dha tërë pa-ratë që kishte, dhe u la i lirë.

Priti disa orë diku në një cep të lulishtes, afër sheshit kryesor, derisa oficeri doli nga zyra. Ky e përshkoi pazarin tej e mbanë se mos nuhaste kundëndonjë send, e, duke mos pikasur gjësendi, u drejtua për në shtëpi. Por nuk arriti dot. Këtë radhë i kishte ardhur koha të jepte llogari për ve-prat e tij mizore prej barbari e shovinisti të tërbuar. Në të hyrë të rrugës Xheladini i doli përpara.

— Ndal, — i tha, — se i kemi nja dy fjalë ba-shkë! A të kujtohet, lum gospodini, se dikur, atëhere ishte i ri, atje në fushë të Kosovës ke dhënë urdhër: Të dalë flaka në kulm të pullazit! E kujt? Shtëpisë seme! Sa kohë që s'jemi parë, por të njofta, të kuj-tova! Paskë ardhë në Gjakovë, ë?

— Ik, more pis, se po të kalb në burg, — ja priti oficeri duke ju mbajtur goja. Desh të ruante gjakftohtësinë, të përmbahej, por nuk qe e mundur. U bë dyll i verdhë në fytyrë. E pa se nuk i kishte punët mirë.

— Jo, besa, po kalbesh ti në tokë, si është rrënuar me urdhërin tënd shtëpia eme.

Me shpejtësi vetëtime, pa i lënë kohë oficerit as të kujtohej për të nxjerrë revolen, i nguli thikën në anën e majtë të gjoksit, mu nën shenjat e dekoratave që kishte marrë për «merita të shquara shërbimi».

Xheladini mori malet. Diku, në një katund të Pejës, gjeti edhe pushkën e gjerdanin dhe nisi jetën e komitit. Shpesh ra në përpjekje me xhandarmërinë.

Jeta e komitit ja forcoi ndjenjën e lirisë.

Një mëngjez të vrenjtur me shi e me mjegull, kur i kishin mbetur vetëm disa hapa për të kaluar kufirin, befas u ndesh ballë për ballë me një patullë jugosllave të rojes së kufirit. Këta, pa i folur, shtinë, por Xheladinin nuk e kapi asnjë plumb. Pushka e gjatë, një mauzer i vjetër, nuk e la në baltë. Palosi për tokë dy prej tyre, ndërsa i treti ua mbathi këmbëve pa guxuar të kthente as kokën.

Me hapa të plogët, disi me zemër të thyer, e kaloi atë copë rrugë e u fut në Shqipëri. Ashtu si që moti, e pritën mjaft ftohtë. Fillkat i vetëm u end poshtë e lart për punë. U sorollat sa i ranë këmbët e askush nuk ja dha dorën. U paraqit në sa e sa zyra e kërkoi ta vendosnin kund në punë ose në ndonjë copë tokë, por zyrtarët e satrapit Zog nuk e vëzhgonin as me sy. Bile gjatë kohës që ndejti duke pritur për punë, i ranë në gjurmë agentët e serbomëdhenjve e desh e vranë. Shpëtoi vetëm në saje të shkathtësisë së vet.

Pas shumë rropatjesh zuri punë të përkoshmë në Vlorë. Punonte herë si murator, herë si argat.

Kur ishte pa punë rrinte zakonisht në kafenenë e «Gegës» si e quanin asokohe në Vlorë, kafenenë e një gurakuqasi. Aty u njoh me lebër dhe disa prej tyre e këshilluan të zinte punë në kripore dhe ashtu bëri. Puna që e rëndë, por Xheladini e përballonte. E keqja ishte diku gjetkë. Asokohe Vlorën e mbyste malarja. Edhe Xheladini nuk i shpëtoi dot asaj dhe u shtrua në spital. Atje u njoh me ish-postkomandantin e Sevasterit kapter Myslim Kaçupin. Ky i propozoi të shkonte hyzmeqar në shtëpi të tij, në Nivicë të Kurveleshit, vend malor e bujqësor. Kjo i pëlqeu Xheladinit dhe pasi dolën nga spitali shkuan bashkë fill e në Nivicë. Kështu nisi jetën në Labëri «Gega i Nivicës», si e quanin lebërit Xheladinit.

Ndonëse Xheladini ishte pajtuar si yzmeqar, Myslym Kaçupi për ta shfrytëzuar, me fjalë, në pamje të jashtme e trajtoi si mik, «si malësori malësorin». E trajtoi kështu, sepse Xheladini ishte jo vetëm bujk i aftë, por edhe i zoti për të drejtuar më së miri tërë ekonominë e shtëpisë, sado jo të madhe të Kaçupajve. Pas tri-katër vjet pune të lodhshme pa shpërblim, veç bukës së gojës e strehës, Xheladini krijoi familjen e tij. Bile Kaçupajt, duke qenë të kënaqur nga sjellja e tij burrërore e puna e papërtuar, duke dashur ta mbajnë gjithnjë afër, ndërmjetësuan e e fejuan e pastaj e martuan me Zilkade Sejdinajn nga fshati Ninësh i Fratarit të Mallakastrës. Si u martua, Xheladini u largua nga shtëpia e Kaçupajve dhe zuri troje larg fshatit Nivicë, në rrëzë të malit, në vendin e quajtur Stok, ku ndërtoi një kasolle dhe hapi disa dynym tokë sa për të jetuar. Afër tij banonin edhe familja e Levend Kaçupit e dy a tri familje të tjera, në gjendje të vështirë ekonomike. Jeta fami-

ljare e bëri Xheladinin më të shoqëruar e më të shkuar me shokë.

Si në punët bujqësore, ashtu edhe në shtëpi, ai punonte me zell e vullnet të papërkulur. Edhe pse i vetëm, pa kurrfarë ndihme, me forcën e krahëve e vuri punën disi për fije. Por kur nisi ta ndjente veten si familjar, i ndodhi një fatkeqësi e madhe, e cila ja vrugoi jetën.

Pas një vit e ca martese, kur i kish lindur edhe djali, Avdiu, u sëmur rëndë e shoqja. Mjek afër s'kishte. I duheshin ditë të tëra ta çonte me kafshë në Vlorë apo në Gjirokastrë. Po me se? Duheshin edhe shumë para për mjekimin e ilaçet. Ato Xheladini as nuk i kishte, as nuk mund t'i gjente. Kështu sëmundja bëri të vetën. Bashkëshortja e Xheladinit, si shumë fshatarë atëhere, i mbylli sytë në moshë krejt të re. Kjo fatkeqësi e tronditi së tepërmi Xheladinin. Atë e shqetësonte shumë fati i foshnjës, që nuk kishte mbushur ende gjysmën e motit.

Ndërkohë, meqë ishte bujk i zoti e me përvojë dikush nga fshatarët i propozoi Xheladinit të bëhej bujk i tij. I premtoi pagë të mirë në dorë dhe të tretën e tokës. Xheladini, edhe pse në kulmin e vështirësisë, e hodhi poshtë propozimin.

— Jam fshatar i lirë, e i lirë dua të vdes, — u shpreh në mënyrë të prerë Xheladini. Mbështetje Xheladinit ju bë plaka Tana Kaçupi. Ajo i mori foshnjën e, bashkë me të shoqin Levend Kaçupin, e rriti Avdiun e vogël si të ishte i veti.

Ditët kalonin e ngjarjet rrokulliseshin si në vorbull. Në malet e Kurveleshit u dukën partizanët e parë. Xheladini qe një ndër të parët që pa asnjë lëkundje ju përgjegj kushtrimit të partisë. Ai rroku


pushkën e doli maleve. Nuk e pleqnoi gjatë as se do të kujdesej për fëmijën e vetëm jetim. Ai vuri në peshore jetën e vet e të fëmijës dhe lirinë. Liria e atdheut, liria e popullit që për të më e shtrenjtë. E me besim në vete, në forcat e popullit, ai ndoqi rrugën e partisë, vuri yllin në ballë e ju kushtua me mish e me shpirt luftës për liri.

NGA NJËRI AKSION NË TJETRIN

Më 1 prill të vitit 1942, sipas udhëzimeve të komitetit qarkor të partisë, partizanët ilegalë të Kurveleshit organizuan çetën e parë partizane të krahinës me tetë vetë të përhershëm, që përbënin bërthamën kryesore të çetës, dhe rreth dyzet vetë të përkohshëm, të cilët bënin pjesë në njësitet guerri- rrele të fshatrave dhe mblihdeshin të tërë ose pjesërisht herë pas here, sipas gjendjes ose planit të veprimeve luftarake, të aksioneve të hartuara nga çelula e partisë.

Në ato ditë partizanët bënë betimin në majën Shahe të malit të Gusmarit. I pari u betua Mustafa Matohiti, sekretari i celulës së partisë të krahinës dhe komisar i çetës. Kur Mustafai shqiptoi fjalët «Mbi kokën e tradhëtarëve do të bjerë shpata e pamëshirshme e urrejtjes popullore», Karadaku e shikoi me tërë vëmendjen e përqëndruar, sikur të donte të shfrente diçka. Si më i moshuari, pas Mustafait, u ngrit në këmbë, e, duke kaluar mali- herin në dorën e majtë, nderoi me grusht dhe nisi të shqiptonte një nga një fjalët e betimit. Zëri i tij i hollë e kumbues, me atë theksin karakteristik të dialektit të Kosovës, dridhej nga mallëngjimi. Me fytyrë të skuqur prush shtoi:

~~56244~~
34807



— Tradhëtia duhet të zhbihet, tradhëtarët të zhduken e me lang e me plang të bahen fani.

Fshiu bulat e djersës, shikoi rreth e rrotull dhe u ul.

Karadaku ishte shumë i vendosur, zbatonte me përpikmëri të plotë çdo vendim të celulës apo të komandës së çetës, edhe po qe se do t'i kërkonte sakrificën më të madhe, jetën. Me qëndrimin e patundur e të prerë ai fitoi besimin e nderimin e shokëve.

Në pamje të parë Karadaku dukej sikur kishte një të metë: fliste pak. Por kur ishte puna për të sqaruar në popull vijën e partisë, ai i trajtonte çështjet me zgjuarësi, dinte të përshtatte bisedën «si të jetë vendi bëhet edhe kuvendi». Fjalët e pakta e të prera i plotësonte me vepra, me dinamizmin, guximin, ashpërsinë në luftim kundër armikut, me zgjuarësinë e natyrshme për të dalë faqebardhë në kushte shumë të vështira e të ndërlikuara, me karakterin e tij të fortë e të palëkundur. Ai propagandonte më së miri me qëndrimin e përpiktë si partizan, me hovin e vrullin e papërmbajtur për t'u hedhur i pari në sulm, ku ishte vendi më i rrezikshëm, e për t'u tërhequr i fundit nga luftimi. Karadaku ishte një hero i heshtur, për të fliste vetëm vepra e tij, shokët e çetës e populli, për të cilin luftonte.

Në qershor të vitit 1942, celula e partisë mori vendim të zhdukej spiuni i shërbimit të fshehtë italian, nënprefekti kuisling i Kurveleshit, Novruz Taçi. Për këtë punë mjaft të rëndësishme e të vështirë për kohën u ngarkua një njësit i përbërë nga Behxhet Mema, Karadaku, Dilaver Poçi e Dalip Seferi.

Nënprefekti kishte përcjell autoritetet fashiste deri në Golem, të cilët kishin bërë një vizitë plot bujë në Gusmar, dhe po kthehej së bashku me sekretarin e komunës dhe një roje, që të tre të armatosur. Njësitë i zuri pritë në Qafë të Koçës, pranë Lerës së Goleme, në rrugën Golem-Gusmar. Kur tradhëtari hyri në pritë, njësitë i thirri: «Ndal!» Nënprefekti kërceu nga kafsha e u përpoq të zërë pozicionin luftim. Mirëpo, i trembur për vdekje, nga frika nuk që i zoti të qëndronte. Si ja shpallën vendimin se ishte dënuar për tradhëti të lartë ndaj atdheut, e pushkatuan. Për të sqaruar popullin i ngjiten një letër me këtë mbishkrim: «Ky ishte një spiun i fashizmit, kushdo që si ky do të veprojë, të njëjtin fat do të pësojë!».

Rojës i morën armën dhe e lanë të lirë me gjithë kafshë. Sekretari i komunes iku i tmerruar. Ai arriti i çmendur në Progonat e bërtiste «Na vranë, na vranë, shtatë qillo!» Këtë e përsëriste sepse në çastin kur kishin rënë në pritë kishin qenë duke biseduar me nënprefektin që nga bereqeti i tërhequr për krahinën nga shtatë kilogram për frymë t'i shisnin popullit e tepicën t'ua jepnin sipërmarrësve matrapazë.

Në këtë aksion Karadaku u tregua i vendosur dhe krejt i qetë, si të mos ndodhte asgjë me rëndësi.

Aty nga fundi i qershorit të vitit 1942, Behxhet Memë, Karadaku e Dalip Seferi shkuan fshehurazi në Gjirokastër për të kryer disa detyra të veçanta që u ngarkoi partia, për të ndihmuar njësitet guerrile të qytetit. Pasi ndenjen një javë nëpër bazat e qytetit, ata u kthyen përsëri në malet e Kurveleshit.

Pas vrasjes së nënprefektit, celula e partisë vendosi që disa shokë, ndër të cilët edhe Karadaku, të shkonin për të punuar për një farë kohe në krahinë e Zagorisë. Mirëpo duke qënë se reaksioni grumbulloi forca në Kurvelesh, celula e partisë, me porosi të komitetit qarkor, bëri një ndarje të re të komunistëve në krahinë. Karadaku u kthye në Kurvelesh.

Bashkë me Behxhet Memën shkoi në Bolenë. U ndalën te dyqani i fshatit, që ishte mu në shtëpi të Behxhetit. Aty ishin rreth tridhjetë burra. Ndër ta ndodhej edhe një shoku i tyre, që sapo ishte liruar nga burgu. Njëri nga paria ju drejtua Behxhetit e, duke ju kapardisur, i tha:

— Ju, komunistët, rrini urtë, mos luftoni, fshihuni e shpëtoni kokën dhe të huaj këndeje mos na sillni (ishte fjala edhe për Karadakun), përndryshe do t'ju dorëzojmë vetë te autoritetet kompetente. Behxheti ju përgjegj:

— Ne s'kemi marrë dyfekun në dorë për t'u fshehur, por për të luftuar armiqtë, ju s'mund të na ndaloni. do të vemë e do të vijmë te kush të na pranojë. Fundi i fundit ashtu si ti jam edhe unë, bolenas e në vendin tim, në trojet e mija nuk të pyes të vij apo jo, kam të drejtë të vij e do të vij sa herë të më sjelli puna.

Kur pa se u acarua kuvendi, Karadaku doli te dera e dyqanit, nxori granatën e me sigurecë të hequr po e mbante në dorë. Dëshën s'dëshën njerëzit e parisë i lanë fjalët. Mirëpo njeri prej tyre shkoi në Brataj dhe lajmëroi karabinierinë e milicinë se në lagjen Hundë e Xhepaj të Bolenës kishte partizanë. Karadaku kishte rënë në një shtëpi.

Natën fashistët e rrethuan. U dëgjuan zërat e tyre. I zoti i shtëpisë e zgjoi Karadaku. E zonja e shtëpisë desh ta fshihte në juk të rrobave.

— Nuk është punë që bëhet, — tha prerë Karadaku. — Ku janë shokët? — pyeti ai qetë dhe nxori dy granata. I hodhi njerën pas tjetrës, çau rrethimin e u bashkua me shokët.

Në këtë rast Karadaku përdori granatën e ndeshjen ballazi se këto ishin i vetmi mjet i përshtatshëm për të dalë nga rrethimi.

Ai kishte aftësi të vlerësonte drejt gjendjen e krijuar e në çast të merrte vendim të matur me gjakftohtësinë më të madhe. Kur e lypte nevoja, ai edhe i shmangej përpjekjes, gjarpëronte e rrëshqiste pa u dukur. Kështu bëri në rastin që po përshkruajmë.

Çeta kishte një bazë të fshehtë në Bregdet, një shtëpi të vetëmuar, buzë një shkëmbi të lartë. Këtu ajo merrte lajme për lëvizjen e armikut gjatë gjithë bregdetit, prej Vlore e deri në Sarandë. Kjo bazë nuk duhej të diktohej nga armiku, duhej ruajtur prej syrit të tij. Një natë Karadaku ju desh të shkonte patjetër në atë shtëpi bashkë me disa partizanë. Një spiun që i kishte pikasur e lajmëroi karabinierinë. Kjo i rrethoi me forca të shumta. Karadaku e kuptoi rrezikun, por ruajti gjakftohtësinë. Nuk ishte punë e vështirë për të që të çante rrethimin me pushkë, po baza duhej shpëtuar. Duhej të vihej në pozitë të vështirë informuesi, të hiqej dyshimi se partizanët lëviznin asaj ane, sepse mendohej që aty të kryhej një aksion i rëndësishëm. Karadaku çeli një derickë të vogël dhe zbriti poshtë shkëmbit thikë me litar. Pas tij zbritën një nga një partizanët e u zhdukën pa lënë asnjë gjur-

më. Kur zbardhi drita, karabinierët sulmuan shtëpinë, por për habi të tyre ajo ishte e zbrazët. Kështu shpëtoi baza pa u zbuluar dhe çeta pa u dëmtuar.

Në tetor të vitit 1942 celula e partisë mori vendim të zhdukte spiunin e rrezikshëm Safet Selimi, një ish-toger i fshehtë i shërbimit të informacionit ushtarak italian (SIM).

Zhdukja e Safet Selimit ndryshe nga e nënpre-fektit paraqiste një tok vështirësish.

Ai ishte vendas prej Bolene, kishte farefis e lidhje miqësore. Nga ana tjetër, megjithëse populli e dinte se ishte spiun, vegël e pushtuesit, sepse tri herë me radhë kishte ndihmuar ekspeditat ndëshkimore të fashistëve, askush nuk e dinte se ishte oficer, pasi nuk vishte kurrë uniformë. Për zhdukjen e tij u ngarkua njësi i përbërë nga Behxhet Mema, Karadaku e Kadri Aliu. Disa ditë me radhë ata e përgjuan për ta vrarë jashtë vendit, por pa dobi, kështu që u detyruan t'i zënë pritë afër shtëpisë së tij në Bolenë. Ishte 8 tetor 1942. Mëngjez. Pritën e zunë me shumë kujdes. Nga do që të lëvizte për të dalë, në derë apo në ballkon, spiuni do të hinte në shënjestër të pushkëve partizane.

Safeti doli në ballkon dhe nisi të kundronte shpatin. Krisën pushkët. Jehona e maleve i ktheu krismat në një buçimë të vetme. Spiuni ra. E pritën të çohej, të lëvizte, por jo, ai nuk dha asnjë shenjë jete! Ashtu si ra përmbys, ashtu dhe mbeti. Pushkët partizane ja kishin arritur qëllimit me bataren e parë.

E NDOQËN KATËR MBRETËRI

Pas pak kohe, duke vlerësuar shumë lart trimërinë e pashoqe, besnikërinë ndaj vijës së partisë dhe qëndrimin burrëror të Karadakut në çdo veprim e situatë, Mustafa Matohiti shtroi për shqyrtim në celulë çështjen e pranimit të Karadakut në radhët e Partisë Komuniste Shqiptare. Asnjë nga shokët nuk shfaqti ndonjë mendim të kundërt. Ata i kishin të freskët në kujtesën e tyre shembujt e shkëlqyer të besnikërisë e të burrërisë së Karadakut.

* * *

Mustafai e thirri e i foli gjatë mbi detyrën e komunistit për të qenë gjithnjë në krye të masave, në ballë të luftës për liri. Karadaku, pasi e dëgjoi me vëmendje të madhe, i tha:

— Shoku Mustafa, po të them atë çka më thotë vetë zemra. Disa vjet me radhë më ndoqi këmba-këmbës xhandarmëria jugosllave. Në atë mbretëri nuk kisha mundësi të jetoja, sepse isha armik i saj. Kalova në Shqipëri. Në vend që të më mbante, xhandarmëria e Zogut përkrahte ata që donin të më vrisnin. Edhe ajo më ndoqi. Kështu u bëra armik edhe i kësaj mbretërie, që ishte, si të thuash, pjellë e së parës. Gjeta strehë vetëm këtu në malet e Kurveleshit. Në mes të këtij populli e ndjeva veten të sigurt. Por ja, plasi lufta italo-greke. Erdhën andartët e

mbretërisë helene. Më quajtën «spiun e shovinist». Më internuan në një kamp thellë në tokën greke. Munda të shpëtoj me shpirt ndër dbëmbë. U bëra armik i mbretërisë së tretë. Sa ktheva në familje, papandehur më kapën karabinierët e më internuan në Vlorë, ku për pak gjeç lashë kokën. U bëra armik edhe i mbretërisë së katërt, i Italisë fashiste të tetë milionë bajonetave. Prej kohësh e kam vrrarë mendjen: ç'rrugë të ndjek, ç'të bëj për të shpëtuar një herë e mirë veten e shokët e mi nga ndjekjet? Mendova shumë, gjykova sipas fjalës popullore «shtatë herë mat e një herë pre» dhe më në fund e preva: rruga e shpëtimit të popullit është rruga që po tregon partia. Për mua rrugë tjetër s'ka veç asaj. Rruga e partisë është rruga ime, lufta e partisë është jeta ime. Për këtë jam gati të bëj çdo sakrificë.

Pranimi në parti që një ngjarje e shënuar në jetën e tij. Posa sekretari i celulës, Mustafa Matohiti, i njoftoi vendimin e celulës, Karadaku i shkëlqeu fytyra e plot emocion u tha shokëve: «Beto hem se do të jem besnik deri në vdekje i partisë e do të zbatoj pa as më të voglin ngurrim fjalën e saj, edhe sikur të duhet të jap gjakun e jetën time». Shokët e përqa-fuan.

Karadaku me të vërtetë nuk e shkeli kurrë beshtimin, nuk e theu besën e dhënë. Ashtu si i ka hije komunistit, Karadaku e mbajti lart titullin e denjë të anëtarit të partisë, luftoi deri sa shkriu jetën për ideolet e partisë e mësimet e saj.

Më 11 nëntor 1942, çeta e Kurveleshit rrethoi postkomandën dhe komunën e Kuçit. Fashistët, milicët e xhandarët, duke mos pasë rrugë shpëtimi, u dorëzuan. Menjëherë, sa çel e mbyll sytë, në Ku-

çin e lirë, pa fashistë tradhëtarë, u mblodh populli për të krentuar këtë ngjarje kaq të rëndësishme.

U mbajtën fjalime e biseda sqaruese me popullin. Ndër ata që folën qe edhe Karadaku. Në bisedën e tij, ndonëse të shkurtër, vihej re theksi i të folurës së Kosovës. Shumë nga populli e njihnin vetëm si «gega i Nivicës». Kur u muar vesh se ishte prej Kosove të gjithë u gëzuan. Zunë të flisnin se pushka partizane kishte krisur në tërë Shqipërinë, se këtu, në mes të lebërve, luftonte një kosovar, ashtu si qindra lebër në krahina të ndryshme luftonin krah për krah vëllezërve të tyre.

Çlirimi i Kuçit pati një jehonë të madhe. Fill paskëtaj fashistët mobilizun tërë forcat e tyre për të ushtruar sa më shumë trusje mbi popullin trim e kreshnik të Labërisë. Ndër ata që u vu në këtë rast në krye të punës për të përçarë popullin e për të penguar Luftën nacional-çlirimtare qe edhe Zenel bej Gjoleka. Ai, me fjalë thumbuese si me doreza, kudo që i binte rasti të fliste, mundahej të qortonte partizanët për këtë veprim.

— Unë jam marrë me politikë e i di mirë punët, nuk kapemi dot ende me Italinë e madhe, — tha ai në një bisedë me popull, ku kishte edhe partizanë.

Karadaku ja priti flakë për flakë:

— Hej, more bej, ore lumëmadh, boll na përrallose me atë politikën tënde, se asgjë s'na bëre, prapë pa liri është Shqipëria. Tash e tutje do ta bëjmë vetë politikën, se fjalën e ka gryka e mauzerit, — dhe goditi me shuplakë të dorës fort anash grykën e pushkës. Lebërit që ishin përreth qeshën në shenjë miratimi, ndërsa beu i prekur në sedër u largua buzëvarur.

28 NËNTOR 1942

Tridhjetëvjektorin e pavarësisë partizanët e Kurveleshit vendosën ta festonin në krahinën e tyre të lirë, pa këmishëzinj e pushtues. Për këtë ngjarje historike kaq të madhe, celula e partisë mori masa të rëndësishme, ndonëse në kushte shumë të vështira e të ndërlikuara. Gusmarin, qendrën e nënprefekturës, e sulmuan nga të katër anët çeta partizane, njësite guerrile të fshatrave e të popullit. Karadaku, si më i pjekuri në moshë, mbante të vetmen armë të «rëndë» të çetës, mitralozin, të cilin e kishte vendosur në një varosh të veçuar, të quajtur «Varri i Kasëmit». Prej andej rrihte gjithë sheshin. Në varosh kishte ngritur edhe flamurin e çetës. Kur krerët fashistë e tradhëtarë kapitulluan e së bashku me nënprefektin po kalonin kryeulur për në vendin e grumbullimit, komandanti i çetës thirri atë çast: «Vdekje fashizmit!». Një pjesë e tyre nguroi të përgjigjej me fjalët «Liri popullit!». Atëhere komandanti i çetës i urdhëroi të ndaleshin. Fashistët shtangën në vend. Kardaku, që i kishte si në shuplakë të dorës, pyeti duke piskatur:

— T'u iap një breshëri kositëse me mitroloz e t'i zhduk njëherë e mirë këta plehra të zeza?

— Lëri, Karadak, — thërriti komandanti i çetës.

tës, — këta kanë mbaruar. Tani po hapin varrin e tradhëtisë së tyre, të bashkëpunimit me pushtuesit, Karadaku ngriti mitralozin e shkoi te shokët. Ndërkohë masa, partizanë e popull, u mbledh në sheshin kryesor. Aty, përpara ish-nënprefekturës, komandanti i çetës i dha Karadakut flamurin kombëtar. Karadaku me flamur në krah hipi lart në ballkon, hoqi flamurin me shpatat e liktorit e me kuroren e Savojës, e shkeli me këmbë dhe e hodhi poshtë si paçavure. Në mes të një gëzimi të papërshekruar të popullit trim të Kurveleshit, në vend të tij ngriti krenar flamurin kombëtar. Si e shpalosi mirë e mirë në shtizë, që të valvitej sa më lehtë, e puthi dhe tha: O flamur, bre, ti je krenaria e popullit shqiptar! Betohemi se s'kemi për të lënë kurrë të të përlyejë kush, për jetë të jetës.

Karadakut ato çaste i shkëlqente fytyra prej gëzimit. Bëri majtas dhe i lëshoi vendin komisarit Mustafa Matohitit, për të mbajtur fjalën e zjarrtë që ngriti peshë zemrat e malësorëve të Labërisë. Prej kënaqësisë që i gufonte nga thellësia e zembrës Karadakut nuk i rrihej pa lëvizur, nuk i zinte vendi vend. Ai rendte herë te një grup populli, herë te partizanët duke shfaqur ndjenjën madhe të haresë që e kishte pushtuar.

KOMITI I VOGËL

Si i vdiq e shoqja. Karadaku desh ta çonte fëmijën e mitur. Avdiun, në Ninesh të Mallakastrës, te prindërit e së shoqes. Po plaka Tane Kaçupi nguli këmbë ta mbante vetë. Karadaku i tha se fëmija do t'i nxirrte kokëçarje, se nuk do të kishte njeri për t'u kujdesuar për të. Tane Kaçupi nuk ndryshoi mendim, pranoi ta rriste qoftë edhe pa babë e nënë, sikur e shpreh edhe në vajin për Karadakun:

*Mua ma humbe mentimnë
Më le vetëm jetimë.
Ti djalin ma le në brëngë
Hem pa babë e hem pa nënë.*

Tane Kaçupi e mbante e kujdesej për Avdiun e vogël si të ishte i barkut të saj, edhe pasi Xheladini doli partizan.

Të tërbuar nga veprimet e fuqishme aktive të partizanëve të Labërisë, qeveria fashiste e Tiranës dhe pushtuesit italianë organizonin herë pas here operacione ushtarake kundër krahinës së Kurveleshit. Një operacion të egër ndërmerën edhe në vjeshtë të parë të vitit 1942. Bashkë me forcat ushta-

rake fashiste italiane e nën mburojën e tyre kishte shkuar atje edhe prefekti i Gjirokastrës, krimineli Tahir Kolgjini. Ky e kishte halë në sy Karadakun. Kishte marrë vesh se një plakë mbante djalin e tij. Vendosi ta merrte djalin, komitin e vogël, dhe, pasi ta kishte në dorë, mendonte të bënte presion mbi Karadakun. Çoi milicët ta merrnin, por plaka labe Tane Kaçupi e fshehu. Milicët e xhandarët, sado që e kërkuan «komitin e vogël», s'e gjetën dot gjëkund.

Shkoi vetë prefekti. Në fillim e kobiti plakën, i premtoi para, por, duke parë se s'po tundej, e kanosi, po edhe ashtu s'nxori gjë në dritë. Meqë nuk ja doli në asnjë mënyrë ta shtinte në dorë fëmijën, urdhëroi ta bastisnin kasollen e plakës.

*Po s'pranova as Kolgjinë,
Kur erdhën djalin të mirrnë,
Më bastisnë dhe shtëpinë.
M'i bënë rraqet bëtajë.
Kasolles m'i vunë zjarrë
Milicia me xhandarë.*

Reaksionarët flisnin andej-këndej për Karadakun se ishte i huaj, njeri pa plang e pa shtëpi, se donte t'i bënte edhe lebërit si veten, prandaj duhej të dëbohej nga krahina. Kështu ata donin ta shkëputnin nga trualli i Labërisë. Mirëpo djegja e kasolles e të kërkuarit e djalit tregonte se ata e pranonin se Karadaku kishte shtëpi e fëmijë, se ishte njeri me plang e me shtëpi.

*Unë e zeza vura vajnë,
Ata qeshnë e më thanë:*

*«Ti, moj plakë, e dogje fshatnë
Sepse je me partizanë».*

Disa kohë pas operacionit, ndërsa çeta po kalonte afër Nivicës, Karadaku mori leje nga shokët e shkoi të shihte të birin. Plakën e gjeti të zënë me punë, ndërsa Avdiu i vogël po qante. Duke e parë në atë gjendje, u pikëllua shumë. Me zemër të thyer i tha plakës:

— Po e marr djalin ta çoj në Ninesh.

Plaka u zemërua, ja hoqi djalin prej prehërit e ju përgjegj plot inat:

—Do ta rris vetë.

*Jo, mor jo, pusho i qetë,
Se djalin do ta rris vetë,
Do ta rrit, e ta rrit mirë,
Ashtu si je rritur tinë,
Me bukë, djathtë e shëllirë.*

Duke parë se plaka e kishte fort në zemër djalin, Karadaku nuk ja zuri ngoje më atë punë. Ajo u kujdes për Avdiun e vogël deri sa u çlirua vendi, ndërsa më vonë e mori shteti që e edukoi dhe e rriti.

NE ÇETEN «HAJREDIN TREMISHTI»

I regjur nga përvoja e fituar, Karadaku nuk ishte vetëm trim, por kishte edhe aftësi për ta goditur e për ta dëmtuar armikun atje ku ky nuk e priste, duke i ruajtur forcat e veta. Për këto veti atë e caktuan zëvendëskomandant të çetës «Hajredin Tremishti», sapo kjo u krijua (më 7 dhjetor 1942).

Përleshjen e parë me armikun kjo çetë e bëri në Borsh të Bregdetit. Aksioni i Borshit ose «luftimi me fortina», si mund të quhet më drejt ky aksion, qe një sulm mjaft i guximshëm. Shtabi i çetës, pasi i studjoi mirë vendin dhe forcat e armikut, vendosi të sulmonte postblokun e Borshit të vendosur në fortina mbi rrugë dhe të mbrojtur mjaft mirë. Çeta kishte 20 partizanë dhe për të kryer aksionin u nda në tre grupe luftimi, që do të sulmonin në tri drejtime. Ndërsa grupi kryesor i forcave të çetës, i drejtuar nga komandanti i çetës, sulmoi nga lindja, Karadaku, që mbante vetë edhe të vetmin mitraloz që kishte çeta, ra, me grupin e drejtuar prej tij, nën rrugë dhe sulmoi nga perëndimi. Ai blokoj me mitraloz dy dritaret e postës aq sa armiqtë nuk mundën të nxirrnin as kokën. Kështu nga lindja partizanët mundën të afroreshin aq shumë sa të hypnin deri në çatinë e postës. Pak përpara agimit, fashistëve italianë u erdhën ndihma prej presidios

ushtarake të Lugës (Porto Palermo). Karadaku mbeti nën rrugë, se ja prenë drejtimin e tërheqjes maqinat italiane. Ai u tërhoq i fundit. Në fillim eci drejt jugut, u doli maqinave nga prapa, pastaj ktheu nga lindja e i arriti shokët në vendin e parashikuar për t'u mbledhur.

Pas ca ditësh komandanti i çetës u sëmur rëndë, kështu që komandant çete u caktua Karadaku. Këtë detyrë ai e kreu me nder deri sa shkoi në Brigadën I S.

Një aksion i rëndësishëm i kryer me shumë sukses, në të cilin Karadaku u tregua jo vetëm trim, por edhe organizator i matur i luftimit në pritë, që shpartallimi i një kolone ushtarake italiane në Zhubdenë më 9 shkurt të vitit 1943. Në këtë kohë çetat «Hajredin Tremishti» dhe «Avni Rustemi» ndodheshin në katundin Nivicë-Bubar. Ato u njoftuan se një autokolonë ushtarake italiane do të nisej nga Saranda në drejtim Borsh-Himarë-Vlorë. U dha kushtimi. Edhe pse ishin mjaft larg, partizanët e të dyja çetave, të prirë prej Karadakut, vrapuan nëpër shi e breshër shumë të fortë, deri sa arritën në vendin më të përshtatshëm për pritë, në kthesat e Zhubdenës. Këtu Karadaku i ndau forcat me mjeshtëri të madhe nga pikëpamja taktike. Në këtë aksion morri pjesë gjithë çeta «Avni Rustemi» e vetëm një pjesë e çetës «Hajredin Tremishti». Meqë komandanti i çetës «Avni Rustemi» ishte më i ri në moshë dhe çeta e tij më e re, ai ja la komandën Karadakut. Ky e zgjodhi vendin dhe i ndau forcat në atë mënyrë që kur të jepte sinjalin për të filluar sulmin secili partizan të kishte pamje të lirë për të hapur zjarr kundër armikut. Mitraloziq e vendosi në një të çarë guri në një vend me rrafsh të gjerë

qitjetje, në mënyrë që të rrihte gjithë hapësirën e kthesave, sa përpara, aq edhe prapa. Vetë qëndroi në ballë. Ishte ora 14.45. Autokolona hyri në pritë, Karadaku me maliher la shakull në vend shoferin e maqinës së parë dhe një kapiten që ishte në kabinë. U ndez i furishëm luftimi. Brenda pak minutash u shfarosën më tepër se tridhjetë armiq e u kapën shumë materiale luftimi, ndër të cilat edhe mitra-loza. Pas luftimit Karadaku drejtoi me gjallëri e shpejtësi pa kurrfarë vonese e dëmi tërheqjen e materialeve, të armëve e të municioneve. U kujdes për mjekimin e shpejtë të shokëve të plagosur lehtë. Si nikoqir i mirë nuk harroi pa tërhequr edhe gomat e maqinave. «Na duhen për opinga», tha ai. Pa humbur kohë, çetat, në rregull të plotë, ju ngjitën malit përpjetë.

Karadaku ishte shumë i rreptë dhe i përpiktë, deri në vetëmohim, për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga partia. Që në fund të dhjetorit të vitit 1942, sipas udhëzimeve të komitetit qarkor të partisë, celula e krahinës së Kurveleshit kishte marrë vendim të hapeshin depot dhe t'i shpërndahej popullit bereqeti e vaji i grumbulluar nga pushtuesit në formë të dhjetash. Depo me disa dhjetëra kuintal misër kishte edhe në katundin Kopaçezë. Karadaku shkoi me çetën për të hapur këto depo. Pasdreke mblodhi popullin në kuvend. Paria e katundit mbajti qëndrim reaksionar, u shpreh haptazi kundër këtij veprimi. Me anë frikësimesh e kërcënimesh ajo u përpoq ta detyronte edhe vegjëlina të shprehej kundër marrjes së drithit të «shtetit». Paria deklaroi «në emër të popullit» se gjoja i gjithë «populli» ishte kundër kësaj pune. Bile një pronar depush e

mbledhës taksash, reaksionar e kapadai, deshi të tregohej edhe trim. Ai u çua në këmbë, tundi në brez revolen, që t'i dukej mirë, dhe tha: «Kanë zot këto palo haure! Po të dëshironi hajdeni e provojeni!» Karadaku ju përgjegj, pa e turbulluar gjakun: «Bëhuni gati. Në mbrëmje ne do t'ju vijmë në shtëpi. Si t'jua dojë zemra ashtu na pritni! Por tani kemi disa punëra të tjera». Pastaj Karadaku, që kishte vendosur roje në vendet kyçe përreth, ju drejtua parisë me këto fjalë: «Ju, paria, jeni kundër kësaj pune, pra, jeni kundër nesh, kundër lëvizjes nacionalçlirimtare, kundër Partisë Komuniste Shqiptare, kundër popullit shqiptar dhe me pushtuesin fashist italian. Këtë misër, — tha ai, duke ju drejtuar veçjëlisë, — e ka grabitur pushtuesi nga populli fukara, pra është i popullit dhe populli do ta marrë, sepse i takon!»

Depot u hapën e populli nisi të merrte drithin, ndërsa paria mbeti si peshku në rërë.

Në buzë të mbrëmjes, pasi vendosi çetën në vendet më të përshtatshme, që t'i dilte përpara çdo të papriture, me mitraloz në teh të krahut, bashkë me tre partizanë, i shkoi në shtëpi pronarit «trim». Kur e pa Karadakun në oborr, pronari reaksionar u frikësua aq shumë sa që as në mend nuk i shkoi të nxirrte revolen. Aq shumë u hutua sa, duke e pasur cigaren të ndezur, kërkonte shkrepset ta ndizte! Kur u largua, Karadaku i tha: «Po të guxojë ndonjeri të zbrazë gojtë edhe një fishek pas shpine, apo të kërcënojë popullin për marrjen e bereqetit, përgjigjeni ju me kokë. Çeta jonë do të vijë përsëri në këto anë!»

Pas disa ditësh Karadaku shkoi me çetën dhe

hapi depot e bereqetit të çifligarëve në Vurg të Delvinës, në Kalivet e Pashait dhe në Çausllli. Një pjesë e katundarëve, e frikësuar nga çifligarët, ngurroi në fillim të merrte misrin, duke menduar se me t'u larguar çeta, çifligarët mund të hakmerreshin. Duke e kuptuar shkakun e drojtjes, çeta u zotua se do t'i merrte vetë nën mbrojtje. Fshatarët e morën gjithë drithin. Çeta u hodh në Vagalat e hapi edhe atje depot e ja shpërndau misrin popullit. Aty një farë agai e dhjetari i doli përpara çetës e, duke protestuar, i tha Karadaku:

— Unë ju kam dhënë fjalën se do të dal partizan kurse ju hapët gjithë depot e shpërndatë tërë misrin tim!

Karadaku e shikoi ashpër e ja preu shkurt:

— Ne lëshime e tregëti me luftën për liri nuk bëjmë. Për ty e për këpusha si ti nuk kemi nevojë. — Dhe aty për aty u kthye nga partizanët e u tha: — E shihni këtë këpushë? Ky nuk është as atdhetar, as shqiptar. Kur gjithë Shqipëria digjet e përvëlohet në luftën për liri, ky kërkon të pasurohet e të bëjë tregëti në kurriz të vegjëlisë, të fshatarëve të këputur, që jetojnë në varfëri. Për kësi njerëzish lufta jonë e ne si çetë nuk kemi nevojë.

Lidhur me këto veprime të çetës «Hajredin Tremishti» komiteti qarkor i partisë për Gjirokastrën botoi më 3 mars 1943 një komunikatë të jashtëzakonshme, në të cilën shkruhej:

«Çeta partizane e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, e komanduar nga Xheladin Beqiri, i shpërndau popullsisë së katundeve Kopaçezë-Vergo 7.000 okë misër kalli të së dhjetës dhe 2.440 okë misër kalli të së dhjetës në Tatzat. Sekuestroi 40

kuintal misër të së dhjetës, që u transportua dhe u depozitua për Luftën nacionalçlirimtare. U shpërndau fshatarëve në Lukovë 33 quintal misër të së dhjetës, që ishte transportuar prej një vendi tjetër në këtë fshat për t'u fshehur.

Po kjo çetë çarmatosi një roje financiare dhe pasi i shpjegoi Luftën nacionalçlirimtare të popullit shqiptar e liroi, duke e porositur që të largohej nga rreshtat e armikut. Katër ditë më vonë, ky u kthye në çetë bashkë me katër shokë të tjerë» 1).

Në kujtesën e fshatareve e fshatarëve të Lukovës ka mbetur i pashyer ky aksion i Karadakut. Tre gojnë me emocion për ashpërsinë, drejtësinë e ndershmërinë e tij.

«Sapo hyri në katund urdhëroi dy partizanë t'u binin këmbanave. Asokohe, në ato anë ashtu jepej kushtrimi. U mblodh i gjithë populli. Si u foli pak fjalë për Luftën nacionalçlirimtare e bereqetin e grabitur popullit e të fshehur aty nga armiku, urdhëroi të hapej depua. Dy rojet, që mbaheshin edhe si ballistë, nisën të kundërshtonin, protestuan me të madhe, por e panë se s'ja dalin dot. Për të penguar këtë aksion, ata shtynë një grua të zinte derën.

— Pa më vrarë mua, — tha gruaja, — nuk hapet depua, nuk lëviz e gjallë nga kjo derë.

Karadaku e kuptoi dredhinë.

— Jo, moj motër, ti nuk duhet të përzihesh në këtë punë, ty nuk të takon të mbrosh armikun, të

1) Komunikatë e jashtëzakonshme, 3 mars 1943. Origjinali ndodhet në muzeumin e Luftës nacionalçlirimtare të Gjirokastrës.

pengosh popullin për të marrë drithin e tij, bukën e gojës së fëmijëve që ka grabitur dhe e ka fshehur pushtuesi këtu. Ti je e gënjyer.

Ajo u skuq dhe u largua. Pastaj vuri dy partizanë te peshorja. Vetë qëndronte në këmbë e thërriste me radhë kryefamiljarët. I pyeste prej sa vetësh përbëhej familja dhe urdhëronte partizanët sa misër t'i peshonin. Kështu, pa listë, me drejtësi revolucionare partizane, brenda pak kohe e shpërndau gjithë bereqetin që pushtuesi kishte grumbulluar e kishte fshehur aty.

Komiteti qarkor i partisë, duke e ditur se Karadaku ishte bërë i njohur në ato anë, e urdhëroi çetën «Hajredin Tremishti» të qëndronte për disa kohë në Vurg e në rrethet e Konispolit. Komunistët e çetës e të terrenit punuan me vrull dhe mundën të shtinin nën ndikimin e partisë shumë katunde. Si pasojë e punës së madhe politike që u bë në këtë krahinë, u krijuan kushtet për formimin e çetës «Çamëria».

Për të shtrirë dhe për të forcuar ndikimin e partisë, një pjesë e çetës «Hajredin Tremishti», e udhëhequr nga Karadaku, në ditët e para të marsit 1943, kaloi nëpër disa katunde të Dropullit të sipërm. Atje, në bashkëpunim me njësitin partizan vendës, bëri një punë të madhe sqaruese me popullin në dobi të Luftës nacionalçlirimtare.

LUFTIMI NË ÇORRAJ

Më 10 prill 1943 një pjesë e çetës «Hajredin Tremishti», e prirë nga Karadaku, ishte nisur për në Borsh. Ndërkohë, fashistët italianë kishin ndërmarrë kundër Kurveleshit një operacion ushtarak spastrues në shkallë shumë të gjerë, duke hedhur forcat e divizionit «Arezzo» dhe forca të tjera policore e mercenare.

Veç anëve të tjera, armiqtë kishin dërguar në drejtimin Borsh-Çorraj- Kuç një detashment që përbëhej nga një batalion i përforcuar. Në afërsi të katundit Çorraj, në vendin e quajtur Rrëza e Vake, Karadaku u ndesh ballë për ballë me pararojën, që ishte një skuadër e përforcuar. Ishte mëngjez heret. Karadaku, si e kishte zakon, po printe përpara çetën me mitraloz në teh të krahut. Vendi që me kthesa. Vetëm disa hapa larg e lejoi buza e kodrës që të shquante armiqtë, të cilët nga frika, kundër zakonit të tyre, po ecnin lehtë e pa zhurmë. Karadaku, pa e humbur gjakftohtësinë, vuri mitralozin në tokë, zuri vend në mes të udhës dhe nisi luftimin pa kurrfarë ngurrimi. Mitralozi, që mbahej nga dora mjeshtërore e Karadakut zemërçelik, me një të kënduar, me brëshërinë e parë, e shoi fare pararojën armike. Ai dha me ngu.

udhëzimet e rastit e njësitit u fut menjëherë i tëri në luftim. Një pjesë zuri pritë, ndërsa pjesa tjetër sulmoi me vrull. Por armiqtë ishin mizëri. Sapo u ndez luftimi, fashistët u hapën anash e ua morën krahët partizanëve, që s'ishin vetëm pak më tepër se një skuadër. Duke parë se ishte rrezik të rrethoheshin e të asgjësoheshin, Karadaku thirri me emër¹⁾ disa nga shokët dhe i urdhëroi të tërhiqeshin me radhë, ndërsa vetë qëndroi në pozicionin që kishte zënë, sepse rastesisht ishte mjaft i përshtatshëm, si të qe zgjedhur me kohë. Partizanët, të mbrojtur nga zjarri i mitralozit, nisën të tërhiqeshin duke luftuar. Kur pa se shokët ishin larguar mjaft dhe ndodheshin jashtë rrezikut, nisi të mendonte se si të dilte edhe vetë nga ajo darë e zjarrtë. Të tërhiqej në drejtim të shokëve tani ishte shumë vështirë, se italianët thuajse e kishin mbyllë me zjarr unazën e rrethimit dhe po e krehnin mirë vendin përpara tyre. Më i përshtatshëm ju duk drejtimi i kundërt. Ai e ngriti mitralozin dhe çau përpara, përmes pyllit. Kaloi nëpër forcat kryesore italiane, pa i hyrë ferrë në këmbë, jo vetëm sepse ai ishte shumë i shkathët e i shpejtë nga këmbët, po edhe pse fashistët ishin hutuar e nuk po i jepnin anë se nga ishin zhdukur partizanët.

Karadaku u doli përpara shokëve në majë të malit. Kur e panë, ata u gëzuan pa masë. Qysh në çastin kur kishte heshtur mitralozit i tij, ata e kishin pritur t'i arrinte, por s'ishte dukur gjëkund. Pas tyre rrethimi qe mbyllur e ata e kishin kujtuar për të vradë.

1) Në çetë asnjëri nuk thirrej me emrin e vërtetë, por vetëm me pseudonime.

KRAH PËR KRAH ME ASIM ZENELIN

Ndërkohë në çetën «Hajredin Tremishti» u cak-
tua komisar Asim Zeneli.

Me taktin e zotësinë e tij Asimi e gjallëroi shumë
punën, jo vetëm për ngritjen e mjeshterisë luftarake
të partizanëve, por edhe për propagandimin e vijës
së partisë. Si komunist i formuar e ushtarak i prega-
titur, Asimi studjonte parreshtur, dhe në kohën e
lirë nga luftimet e marshimet u tregonte partizanëve
ngjarje të ndryshme politike e historike. Kur merrnin
trakte, udhëzime apo materiale të tjera të partisë,
ua lexonte partizanëve ose ua shpjegonte përmbaj-
tjen; sipas rastit bënte sqarimet e nevojshme lidhur
me gjendjen konkrete të çetës, ndërsa me Karadakun
i lexonte dhe i shqyrtonte, herë-herë, edhe veç. Sa
herë Asimi i drejtohej:

— Ja, Karadak, na ka ardhur kjo letër.

Karadaku e merrte, e shikonte dhe ja kthente.

— Na, këndoje komisar, ç'thotë kjo për ne. — Ai
pushtoej i tëri duke dëgjuar komisarin, përpinte
me afsh çdo fjalë të tij, të partisë, si thoshte ai.

Duke kujtuar se Karadaku nuk dinte të lexon-
te, një ditë, ndërsa po e vështronte drejt në sy,
Asimi i tha:

— A thua kurrë, he burrë, s'e ke në mend të lidhesh vetë drejt për drejt me fjalën e shkruar të partisë? Pse, mos vallë kurrë nuk do të lexosh vetë?

— Si jo, bre komisar. Gjithnjë përpiqem. Qysh ditën e parë që erdha në çetë ja kam hyrë mësimit. Edhe pse me vështirësi, por pak e nga pak e kam vënë punën për fije. — Për të provuar ato çka tha nxori nga çanta një fletore shkrimi me shënime si detyra dhe një libër këndimi.

— Pse nuk më kërkon ndihmë? — ja priti Asimi.

Karadaku heshti, ndërroi vështrimin dhe ja nguli sytë librit.

Që nga ajo ditë, në çdo kohë të lirë, Karadaku, i ndihmuar nga komisar, nisi të mësonte edhe më me zell. Të vinte habi të shihje se si një burrë rreth të dyzetave, me dorën e ashpër të pushkës e të mitralozit, të punëve të rënda në të kaluarën, kapte si një fëmijë lapsin e, nën kujdesin e komisarit, mësonte e stërvitej në shkrim e në këndim. Me vullnet të papërkulur, Karadaku brenda pak kohe mundi të lidhej drejt për drejt me fjalën e shkruar të partisë. Ai lexonte lirisht e shkruante jo keq.

Puna luftarake në çetë shkonte shumë mirë. Komisar, Asimi, ishte ushtarak i përsosur; ai mban-te mortajën, ndërsa komandanti, Karadaku, i lerë për luftë partizane, nuk e lëshonte nga dora mitralozin. Komisar e komandanti veç trimërisë, guximit e hovit të pandalshëm në sulm, me armët e tyre të fuqishme, u jepnin krah dhe vëllim zjarri partizanëve pushkatarë në zgjidhjen e detyrave në luftim. Ata ishin drejtues të çetës, por njëherit me armët që mbanin përbënin, si të thuash, edhe bërthamën kryesore të fuqisë së zjarrit.

Asimi dhe Karadaku e mbanin të gjallë frymën luftarake të partizanëve. Ata kishin iniciativë dhe kërkonin të gjenin aksione për çetën. E një herë, nga fundi i prillit 1943 ja ç'ndodhi. Çeta «Hajredin Tremishti» po pushonte në një pyll afër katundit Jermë. Asimi e Karadaku i lanë partizanët në një vend të maskuar mirë, vendosën roje në ato drejtime nga mund të vinte nonjë rrezik dhe vetë dolën të shihnin, të hetonin se ç'bëhej në katund. Atje një kusar e mercenar kishte mbledhur fshatarët e, pasi kishte rrethuar me milicët që kishte nën komandë, po i shtrëngonte të paguanin të dhjetat. I veçonte mënjanë një nga një e nën kërcënimin e kamxhikut e të burgimit i detyronte të paguanin aq sa kërkonte. Ndërkohë diku ranë dy pushkë. Një i ri hapi fjalën se po vinte «çeta e Karadakut». Kështu e quanin në ato anë çetën partizane të Kurveleshit. Me të marrë vesh këtë lajm, që u përhap enkas, pa e ditur kush se çeta ishte me të vërtetë diku atje afër, i tmerruar nga frika, mercenari as që mendoj më të merrej me të dhjetat, por, për të shpëtuar lëkurën, mblodhi me të shpejtë milicët, ja mbathi me të katra dhe e ndali vrapin në Delvinë.

Asimi e Karadaku, duke vëzhguar, po ecnin në drejtim të mbledhjes. Përpara u doli një i ri, i cili, si i informoi për çka kishte ngjarë, u priu e i çoi te fshatarët e mbledhur. Asimi u foli atyre për Luftën nacionalçlirimtare dhe i porositi që të mos u jepnin pushtuesve e shërbëtorëve të tyre as sa mban miza në fletë. Fshatarët mbetën shumë të kënaqur nga fjalët e ngrohta e bindëse të komisarit. Biseda po zgjaste, prandaj dërguan një të ri komunist të njof-tonte partizanët. Por edhe këta, të shqetësuar për

vonesën, kishin dërguar dy vetë të shikonin aty afër e, meqë s'i kishin parë gjëkund, kishin dalë t'i kërkonin. Ata ishin çuditur se si komisari e komandanti ishin larguar ashtu pa thënë asgjë. Dhe tani, pasi morën njoftim, shkuan t'i takojnë. Sa u habitën ata kur i gjetën të shtruar gju më gju me popullin. Aty rreth bënin roje të rinjtë komunistë të fshatit. Sa të tmerrshëm ishin komisari e komandanti për reaksionarët mercenarë, aq të dashur ishin për popullin, për fshatarët e varfër e për bujqit.

Partizanët i kritikuan pastaj për këtë pakujdesi. Ata pranuan gabimin. Asimi shtoi duke qeshur: Kur je me popullin, nuk të gjen asgjë e keqe.

Më 14 maj çeta organizoi një pritë midis katundeve Pecë e Kardhikaq në rrugën Delvinë-Gjirokastrë. Prita që zënë me aq mjeshtëri në të dy anët e rrugës, sa që brenda pak minutave kolona u shfaros krejt, pa pësuar asnjë dëm çeta, ndonëse italianëve u erdhi në ndihmë një aeroplan. Zjarri i mortajës së përdorur me zotësi të rrallë nga komisar Asim Zeneli, dhe ai i mitralozit në duart e shkathëta të komandantit, Karadaku, plotësonin me përpikmëri të madhe zjarrin e partizanëve pushkatarë sypatrembur.

Ky aksion i kryer me shumë sukses pati një jehonë të madhe, sepse u bë vetëm disa ditë pas operacionit, kur armiku kishte shpallur plot zhurmë se çetat partizane ishin zhdukur. Armiku u mundua ta ulte rëndësinë e këtij aksioni. Në raportin e drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë kuislinge të Tiranës, kuestori i Gjirokastrës, ballisti Koço Muka, njoftonte: «Dje mbas dite 14.5.1943 në Pecë çeta komuniste e përbërë prej 20-30 vetësh kishte

zënë pritë ku shkante autokolona ushtarake. E qëlluan me mitraloz e pushkë. U vranë 6 vetë e u plagosën 8. Autokolona u vu në ndjekje të komunistëve»¹⁾). Por nuk mbulohet dielli me shoshë. Këto shifra ishin zvogëluar vetëm për të kënaqur veten.

Pas disa ditësh çeta u ngarkua nga komiteti qarkor i partisë me një detyrë të posaçme, me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake. Krerët e organizatës tradhëtare «Balli Kombëtar» të qarkut të Gjirokastrës organizuan me bujë të madhe një mbledhje të partisë së Kurveleshit dhe Kardhiqit te Rrepet e Rehovës, midis katundeve Golem e Kolonjë të Kurveleshit. Partia mundi ta shfrytëzonte rastin e ta kthente atë mbledhje në një kuvend të gjerë popullor. E pikërisht çeta «Hajredin Tremishti» u caktua nga komiteti qarkor i partisë të siguronte jetën e komunistëve pjesëmarrës në të. Këtu kishin ardhë përfaqësues të komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën dhe shokë me përgjegjësi të krahinës së Kurveleshit. Karadaku u ngarkua me sigurimin e drejtpërdrejtë të mbledhjes. Ai vendosi partizanët në pozicione. Në të gjitha drejtimet nxori patrulla. Mortajën e vuri në pozicion gadi për qitje në çdo anë nga do të shihej e nevojshme. Vetë Karadaku zuri vend në trungun e një rripi të rrëzuar e me maliher në dorë vëzhgonte në të gjitha anët. Ishte, si të thuash, në pikën e vrojtimit. Diku ra një pushkë. Ali Këlcyra, që ishte edhe iniciatori i mbledhjes, u çua në gjunjë e pyeti:

1) AQH i RPSH. Fondi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, viti 1943

— Ç'është ajo pushkë?

Karadaku, që po rrinte në trung mbi kokën e tij, ja priti:

— Ali bej, mos u frikëso, s'keni pse të shqetësoheni po të mos i keni lajmëruar ata miqtë e tu 1) për të ardhë të na rrethojnë.

Ali beu uli kryet e nuk foli.

Në mbledhje komunistët e shtruan çështjen në mënyrë të qartë e të prerë: atdhetar është vetëm ai që i lufton pushtuesit kurdo e kudo: edhe të hash në një çanak me pushtuesin edhe të jesh atdhetar nuk është e mundur, po t'i shërbesh pushtuesit je tradhëtar e jo atdhetar; të tillë duket se janë edhe këta të «Ballit Kombëtar».

Fjalët e komunistëve bënë përshtypje të mirë në popull e ky po u jepte të drejtë. Atëhere gjendja u acarua shumë. Banditi ballist Nano Gjoni nga Picari deshi të afronte disa ballistë të armatosur për të bërë presion mbi komunistët dhe popullin. Karadaku i doli përpara dhe i tha:

— Shporruni që kënde! Ja ku është në pozicion mitralozi. Ai mund të flasë.

Ata u zbrapsën si pula të lagura.

1) d.m.th. fashistët italianë.

LAMTUMIRË, HERO!

Kishte disa ditë që lufta ziente në brigjet e Vjosës. Çeta «Hajredin Tremishti», që quhej edhe çeta e Kurveleshit, për arsye taktike ishte ndarë përkohësisht në dy njësite. Njësi i parë, nën komandën e komisarit. Asim Zenelit, më 30 qeshor këreu një detyrë të rëndësishme luftarake në Damës. Pjesa tjetër, nën komandën e Karadaku, vepronte në anë të përroit të Salarisë. Më 1 korrik erdhi edhe Karadaku me njësitin e vet dhe e njoftoi komisarin se ky ishte caktuar komandant i batalionit partizan «Naim Frashëri», i cili qe formuar ato ditë në katundin Nivan të Zagorisë. Në pasditën e 1 korrikut çeta «Hajredin Tremishti» u nis për t'u ardhur në ndihmë çetave «Koto Hoxhi» e «Musa Fratari», që luftonin në grykën e Mezhegoranit.

Në mbrëmje çeta arriti në qafën e malit të Shëndëllisë. Poshtë në gropë buçiste topi e mortaja. Nga flaka i tërë shpati ndriçonte e skuqte si zjarr. Ndërsa partizanët u ndalën të pushonin, Asimi mbloodhi komunistët e shtabin e çetës mënjanë. Ai theksoi nevojën për t'u futur në luftim sa më parë. U rrahën mendime. Disa ishin të mendimit të prishin sa të organizoheshin, të bënin ndarjen e forcave

të çetës e të vullnetarëve të ardhur e të atyre që priteshin të vinin në ndihmë, të hetonin vendin e të zbulonin forcat e armikut dhe pastaj të futeshin në luftim. Por kjo punë kërkonte kohë e pikërisht koha s'priste! Armiku, me gjithë qëndresën burrërore të çetave të ngujuara prej disa ditësh në luftime, kish-te epërsi në forca e mjete dhe gjendej në kushte të përshtatshme për të arritur sukses. Pra duhej vepruar me shpejtësi rrufeje. Ky qe mendimi sa i drejtë aq edhe i prerë e i patundur i komisarit. Karadaku u shpreh për dërgimin sa më parë të një grupi të vogël zbulimi, i cili do të siguronte futjen më me sukses të çetës në luftim. Zbuluesit u zgjodhën nga shokët më të shkathët, që dolën vullnetarë. Në krye të zbuluesve u vu komunisti Bilal Peçi. Ata u nisën menjëherë në drejtim të armikut. Çështjen e futjes sa më shpejt në luftim Asimi e shtroi edhe përpara gjithë partizanëve. Ata mezi prisnin. Brofën që të gjithë në këmbë. E tërë çeta, duke patur në krye komisarin e komandantin, u nis pa humbur kohë andej nga kërciste pushka, për të sulmuar, për t'u ndeshur ballazi me armikun.

Në marshim e sipër u doli përpara skuadra e dërguar për zbulim. Bilal Peçi u solli mjaft të dhëna që ndihmonin shumë për sqarimin e gjendjes.

Si u informuan mbi gjendjen e armikut e të forcave partizane, në një vend të përshtatshëm u ndalën, vlerësuan situatën e morën vendime se si dhe në ç'drejtime do të sulmonin.

Vendosën që kundër armikut të sulmonin në tri anë. Në të majtë Karadaku, në mes Asimi dhe djathtas pjesa tjetër. Çasti ishte kritik dhe vendimtar për forcat partizane. Karadaku nderoi me grusht

e në krye të partizanëve mori majtas dhe pas pak sulmoi furishëm. Në mes komisari çau përpara me hov të pandalshëm.

Lufta u ndez e përgjakshme. Sulmi i lebërve qe i rrufeshëm. Fashistët italianë me dëshpërim po i bënin ballë furisë partizane. Mirëpo duke parë se partizanët po sulmonin me vrull të pandalshëm dhe nga frika se mos mbeteshin të rrethuar, u tërhoqën. Ata lanë nëpër brinjët e malit mjaft të vrarë e të plagosur. Partizanët i ndoqën hap pas hapi e nuk u lanë kohë fashistëve t'u zinte këmba dhe e jo më të kalonin në pozicione të reja. Kahdo armiqtë po silleshin si në vorbull. Mirëpo një mitraloz fashist, i vendosur në pllajën e malit në një sukë të vogël, rrihte parreshtur gjithë grykën e nuk lejonte përparimin e mëtejshëm të partizanëve. Asimi e pa dhe i thirri Karadaku që në atë çast po luftonte larg në të majtë.

— Karadak, pa asgjësuar atë mitraloz në kodrën djathas, nuk mund të bëjmë asnjë hap përpara.

Karadaku vuri dorën në ballë e për një copë herë ja nguli vështrimin mitralozit e pastaj e vrojtoi me dylbi. Pa i hequr sytë andej u përgjegj:

— E shoh fare mirë. Ai do të pushojë së kënduari si turtull. Nuk do të shpëtojë dot, veç në fluturoftë! Minutat i ka të numëruara. Nuk është shumë larg. Do të ndjek anës së kurrizit të kodrës e do t'i dal nga sipër.

Pa e përfillur mitralozin armik, që me breshëri kositëse rrihte tërë luginën, trimi Asim e vijoi përparimin e s'pat edhe pak e do të binte në rrugë. Por kur fitorja qe e sigurt e gati e arritur, një plumb

e mori komisarín në ballë e e rrëzoi për tokë pa jetë, duke e ndarë përgjithmonë nga shokët. Karadaku me disa partizanë u sul si rrufeja në të djathtë e, ashtu si bie skifteri mbi gjah, u turr me shpejtësi vetëtime e pastaj, si u zvarris edhe një copë rrugë, ju afrua rrëshqanas 10-15 metra mitralozit armik, që villte pa prerë zjarr kundër partizanëve të ngjuar në grykë.

Qe punë minutash. Disa bomba të hedhura nga dora që s'dinte të dridhur e Karadaku plasën te mitralozi. Krismat e fuqishme jehuan nëpër luginë. Tymi e flaka e mbuloi kodrën. Mitralozi heshti bashkë me të gjithë fashistët që e përdornin.

Po të mos vepronte Karadaku me shpejtësi, e guxim të pashoq, gjithë partizanët e futur në grykë zor se do të dilnin të gjallë dhe humbjet do të ishin shumë të rënda.

Luftimet vijuan mjaft të ashpra. Karadaku mbeti vetëm në krye të çetës. Megjithëse ishte jashtëzakonisht i tronditur nga humbja e komisarit, Asimit, shokut të tij shumë të ngushtë të armëve, ai e ruajti gjakftohtësinë dhe e drejtoi çetën me sukses në luftim, duke korrur fitore të shkëlqyeshme.

Në varrimin e Asimit në katundin Mezghoran, Karadaku mbajti këtë ligjëratë të përmortshme, sa të thjeshtë aq edhe të zjarrtë:

«Shoku Asim, ti u ndave përgjithmonë nga ne, që të deshëm e na deshe aq shumë. Ne betohemi para teje se trimërinë, heroizmin dhe gjakun tënd kurrë nuk do ta harrojmë. Me sulm e nisëm e me sulm do ta mbarojmë, me gjak e filluam e me gjak do të fitojmë. Lamtumirë, hero!»

Edhe pas vrasjes së Asimit çeta e komanduar nga Karadaku e kreu me nder detyrën deri në fund. Ajo, në bashkëveprim të ngushtë me çetat e tjera, e ktheu ngrykën e Këlcyrës në një kështjellë të pakapërcyeshëm për fashistët italianë.

Armiqtë, këmishëzinjtë e Duçes, lanë në fuqshën e luftimit gjatë këtij operacioni mbi 120 të vrarë, shumë rob e të plagosur dhe mjaft material ushtarak.

Nga që pësuan shumë humbje, komanda italiane u përpoq të hakmerrej. Por, për t'ja arritur këtij qëllimi, i duheshin të dhëna të sakta mbi forcat partizane e mbi vendosjen e tyre. Për këtë punë, duke mos gjetur tjetër rrugë, dërgoi dy gra të veshura si infermiere, gjoja nga ana e kryqit të kuq, për t'u interesuar për gjendjen e të plagosurve dhe të robërve italianë. Edhe pse nuk kishte të dhëna se ç'ishin ato (vetëm më vonë e morën vesh se kishin qenë agjente të SIM-it), si gra i pritën e i pyetën se ç'kërkonin. Me to foli Karadaku. Pasi i dëgjoi kërkesat e tyre, që nuk ishin të pakta: të lejoheshin njerëz të kryqit të kuq italian, me një fjalë oficerë të zbulimit, të shkonin deri te robërit e të plagosurit, ai u tha:

-- Ata që u kanë dërguar këtu i kanë bërë hesapet dallash. Për robërit e të plagosurit kujdesimi vetë. Ata i kishin shëndosh e mirë e i sollën këtu për t'u copërluar me ne. Ç'kërkonin këtu? Ç'i sollli në këtë vend? Ata i dërguan këtu për të na vrarë. Prandaj edhe ne i vramë ose i plagosëm, i kapëm rob, po disa edhe na ikën. Ata që kemi në dorë i mbajmë e u japim vetë ndihmën e parë e të mbrame. Pra as për ju e as për të tjerët, që duan

të dërgojnë këtu, nuk ka punë, veç nga keni vënë thembrat veni majat e ikni sa më parë në kazermat tuaja!

Duke e parë se s'dilte gjë në krye, ato u larguan për në Përmet.

Luftimet në brigjet e Vjosës, ndër më të mëdhatë e më të ashprat e asaj periudhe, përfuduan me fitoren e plotë e të shkëlqyer të armëve partizane. Në këto luftime si komandant çete dha kontributin e vet edhe Karadaku.

Ballistët, këta agjentë të përdhosur të pushtuesve, e kishin halë në sy këtë fitore. Për të ulur në popull simpatinë ndaj partizanëve, që treguan aq heroizëm, s'linin gjë pa trilluar për komandantët e çetave. Ata lehnin paprerë, si qeni në hënë, duke thënë. «Disa kurveleshas pa zhapa në këmbë kanë vënë komandant një kosovar pa plang e pa shtëpi. Duan të bëjnë si veten e tyre tërë popullin». Edhe këto trillime të armiqve dëshmonin se Karadaku luftonte, ashtu si mësonte partia, si i kishte hije një komunisti shqiptar.

NISJA PËR NË VITHKUQ

Pas përfundimit me sukses të luftimeve në grykën e Këlcyrës, duke u mbështetur në letrën e shokut Enver mbi zgjedhjen e partizanëve e të kuadrove për në Brigadën I sulmuese që do të formohej, komiteti qarkor i partisë për Gjirokastrën organizoi me çetat partizane një mbledhje të madhe në Sheper të Zagorisë. Atje shkuan mbi të dhjetë partizanë. Nga këta do të zgjidheshin vetëm 40 për në Brigadën I S. Ndërsa i deleguari i komitetit qarkor lexonte letrën e shokut Enver, Karadaku dëgjonte me maliher në dorë. Me të mbaruar fjalët: «Kush është gati të dalë vullnetar për të luftuar në njësinë e madhe të rregullt të Ushtrisë Nacionalçlirimtare?» Karadaku brofi i pari në këmbë e, duke nderuar me grusht, thirri: «Unë jam gati! Dua të shkoj e të luftoj në njësitë e mëdha e të rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, dua të luftoj në të katër anët e Shqipërisë, kudo që luftohet për çlirimin e atdheut tonë të shtrenjtë». Mbas këtyre fjalëve u çua në këmbë e gjithë çeta. U desh ndërhyrja e të deleguarit për të caktuar partizanët e kuadrot që do të shkonin në brigadë. Mbas shumë rrahje mendimesh u zgjodhën dyzet vetë. Përgjegjës ushtarak i tyre, për t'i çuar deri në vendin e formi-

mit të brigadës, në Vithkuq, u caktua Karadaku.

Gjatë udhëtimit prej Sheperi e deri në Vithkuq, ndonëse rruga ishte plot rreziqe, ai e udhëhoqi grupin pa pësuar asnjë dëm.

Në katundin Frashër të Përmetit partizanët pushuan një ditë. U grumbulluan shumë fshatarë, disa prej të cilëve e mbanin veten për bejlerë e ishin të lidhur me Ballin. Fshatarët u sollën bukë partizanëve. Pas përshëndetjeve, si u ulën, nisën të bisedonin mbi gjendjen. Nën hijen e një arre vigane Karadaku hapì një kuvend jo të zakonshëm për të. Duke kundruar vendlindjen e vëllezërve Frashëri, e sollì fjalën te Abdyl Frashëri, një nga frymëzuesit e drejtues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

— Abdyl Frashëri, — tha ai, — ka qenë edhe në Kosovë e bashkë me kosovarët ka luftuar për çlirim e Shqipërisë.

Secili tha aq sa dinte për Abdylin, por më shumë folën për Naimin. Karadaku tregoi disa episode të luftërave të Lidhjes së Prizrenit, duke përmendur herë pas here copa këngësh popullore.

Ndërkohë disa partizanë të rinj në moshë nisën të këndonin këngën revolucionare «Pararoja»:

.
*Toka s'do ketë kurr'më zot
Do t'jetë e jona përgjith'jet.*

Disa nga frashëriotët, që e quanin veten bejlerë, curruan veshët. U habitën se si aty, te arra, në trojet e tyre, të bejlerëve, të këndohej një këngë vegjëlie, «harbutësh», siç ishin mësuar t'i thërrisnin ata punëtorët e shtresën e varfër të popullsisë. Karadaku, që

e kishte mjaft të zhvilluar sedrën e klasës, i ra në sy menjëherë shqetësimi i tyre. Që t'u jepte të kuptonin të rinjve pse partizanët ja kishin marrë asaj kënge, duke ju drejtuar atyre që këndonin, tha:

— Vazhdoni, djema, se mirë e keni! Në këtë luftë që po bëhet do të dalë fitimtare patjetër veçjësia. — Pastaj ju drejtua frashëriotëve. — Ju, që keni një të kaluar në zë për atdhedashuri, duhet të ndiqni rrugën e rinisë.

Bejlerët shikuan njëri-tjetrin e heshtën. Askush prej tyre nuk e pa të udhës të fliste. Për të thyer heshtjen, Karadaku e hodhi përsëri fjalën te Lidhja e Prizrenit.

— Në kohën e Lidhjes së Prizrenit, populli luftoi, po nuk kishte një prijës të fortë e të ditur, nuk mundi të bashkohej i tëri dhe nuk u çlirua. Sot e ka një prijës të pushkës e të pendës, prandaj, — shtoi duke i qeshur fytyra, — ne jemi të bashkuar, do të luftojmë e do të fitojmë.

Kujtimi i Lidhjes së Prizrenit dhe i luftrave të saj u lanë një mbresë të thellë si partizanëve, ashtu edhe frashëriotëve. Kjo nuk qe një bisedë e rëndomtë. Karadaku digjej për vendlindjen e tij, për Kosovën, ndonëse fliste pak për të. Xheladini ishte një vijues në kushte të reja i mjeshtërisë së të luftuarit dhe i trimërisë së Sulejman Vokshit e Isa Boletinit, Idriz Seferit e Bajram Currit, Azem Galicës e Zefit të Vogël; ai ndiqte rrugën e shokëve të rinisë, rrugën e Ali Kelmendit e të Asim Vokshit.

Në ahishtet shekullore të Shtyllës grupi i partizanëve të Gjirokastrës qëndroi disa ditë për të pritur sa të mblidheshin edhe shokët e krahinave të tjera. Aty, nën hije, bënin stërvitje ushtarake,

mësonin armët e rënda, kryesisht pushkët kundër-
tanke e mortajajat.

Karadaku tregonte kujdes shumë të madh për
njohjen e teknikës luftarake, mësonte shpejt për-
dorimin e çdo arme.

Dhe ja, dita aq e pritur erdhi! Më 15 gusht
1943, kur Brigada I sulmuese u rrjeshtua në Ma-
kërzë të Vithkuqit për ceremoninë e inaugurimit, Ka-
radaku zuri vend si nënkomandat i batalionit të parë
të kësaj brigade.



Karadaku me shokë të Brigadës I S.

Brigada nuk u quajt më kot sulmuese. Ajo u kri-
jua për luftë. Me të vërtetë, menjëherë pas inaugu-
rimit, më 17-18 të atij muaji, ajo shkoi për

aksion në rrugën automobilistike në afërsi të katundit Barmash. Me një sulm të rrufeshëm e të befasishëm shfarosi një nënrepart marshues gjerman. Të parën pushkë që ju zu nazistëve në këtë për-pjekje, e cila qe pagëzimi në zjarr për forcat e brigadës, në shenjë nderimi për trimërinë e treguar, ja dhanë Karadaku me gjithë pajime. Si u kthye nga Barmashi, më 26 gusht, brigada, që kishte vetëm rreth gjashtëqind luftëtarë, u gjend përballë një divizioni italian me një efektiv prej më se 10 mijë vetësh të përforcuar, të armatosur e të pajisur mjaft mirë e që kryente veprime luftimi në krahinën e Vithkuqit.

Për të shpëtuar nga rreziku i rrethimit dhe për t'ju shmangur dëmeve të mundshme, brigada u hodh në kundërmësymje.

Një pjesë e batalionit të parë, e prirë dhe e drejtuar nga Karadaku, duke shfrytëzuar me mjeshtëri vendin e thyer malor, manovroi me shkaktësi, u doli italianëve pas shpine e me shpejtësi skifteri ju afrua fshehurazi pozicioneve armike, aq sa në befasi të plotë goditi nga pas me bomba dore mitralozin e rëndë «Breda» dhe ushtarët e tjerë në lloçoore. Armiku i vënë midis dy zjarreve u shpartallua keqas. Ky veprim i rrufeshëm e i papritur i tronditi shumë fashistët. Në këtë kundërsulm Karadaku dha shembull të shkëlqyer jo vetëm të një luftëtari trim, por edhe të një mjeshtri të manovrës e të luftimit në rrethim.

Ditët kalonin e luftimet ndiqnin njëri-tjetrin.

Më 10 shtator 1943 Brigada I, si njësi luftarake e rregullt e UNÇSH, filloi luftimet në qytetin e Pogradecit. Edhe këtu, në luftimin e parë në qytet,

ashtu si në shpatet malore të Vithkuqit, Karadaku, në krye të forcave të batalionit, e kreu me sukses detyrën në sektorin e caktuar.

Ndërkohë Italia fashiste u rrokullis në greminë, e bashkë me të edhe pushtimi italian në Shqipëri. Pushtues të tjerë, më barbarë, nazistët gjermanë, zunë vendin e fashistëve italianë. Por edhe mbi kokën e këtyre këndoi pushka partizane.

Në shtator komanda e brigadës vendosi që me një pjesë të forcave të brigadës të godiste gjermanët në Qafë-Kërrabë, midis Mamëlit e Gracenit. Si mori detyrën në vend nga komandanti i brigadës, sqaroi drejtimin dhe radhën e mënyrën e veprimit, përpara se të niste luftimi, Karadaku u foli partizanëve të batalionit të vet:

— A e dini pse kemi ardhur këtu? Të përshëndesim zyrtarisht me plumb nazistët gjermanë. Ata mbahen për të fortë. Kini kujdes, shënoni mirë, se plumbi u ngulet edhe atyre, ashtu si u ngulej fashistëve italianë.

Dhe përshëndetja nuk shkoi keq: katër maqina e dy motoçikleta dhe një numër ushtarësh e oficerësh u asgjësuan brenda pak minutash.

HETO, ZBULO, MANDEJ SULMO

Arti i luftimit del nga përvoja, dhe shpesh përvoja vetjake, praktika në fushën e betejës, i lë gojëhapur mjeshtërit, qofshin ata edhe nga më të përmendurit.

Karadaku kishte përvojë të madhe, tregohej mjaft i shkathët e i zgjuar, i ruante forcat në luftim. Me gjithë guximin e trimërinë e padiskutueshme, ai nuk hynte kurrë në luftim verbazi, nuk kryente veprime të pamatura. Para çdo aksioni, duke u mbështetur në të dhënat sado të pakta të zbulimit, ai vlerësonte gjendjen, armikun e vendin e mandej hidhej me shpejtësi në sulm.

— Heto, zbulo, mandej sulmo, — thoshte ai shpesh. Megjithëse trimëria është e domosdoshme në luftimin, se po të jesh trim nuk e humb, duhet t'i vihet veshi edhe fjalës së urtë popullore të malësorëve tanë: në luftë duhen shtatë herë hile e një herë trimëri. Ky është mishërimi i përvojës shumëshekullore të luftës së popullit me forca të pakta. Hileja, dmth manovra e mbështetur në hetim e zbulim të saktë, krijon mundësi për të sulmuar befas armikun në pikën më të dobët, atje ku nuk e pret, e për ta shpartalluar atë pa të hyrë as ferrë në këmbë.

Një shembull i zbatimit në praktikë të këtij parimi të taktikës popullore nga Karadaku, Gjok Doçi e shokët të tjerë që shfarosja e gjermanëve në çadra në ullishtet e Elbasanit më 27 shtator 1943.

Qe vendosur që të bëhej një goditje aty ku armiku s'e priste kurrë: t'i zihej pritë një autokolone në postblokun e Elbasanit. Në këtë luftim nuk mund të merrnin pjesë shumë forca, sepse nuk mund të manovronin lehtë. U caktuan vetëm 25 partizanë; u caktuan, pasi të gjithë kërkuan me këmbëgjulje të shkonin në goditje. Udhëtuan natën buzë rrugës. U dëgjua një zë njeriu aty afër. Ishte një bari me disa kafshë. E thërritën. Ai u afrua disi i trembur. Kur e mori vesh se ishin partizanë, u tha:

— Kini kujdes, këtu afër janë rreth 70-80 gjermanë në çadra.

Karadaku, Gjok Doçi e shokët e tjerë drejtues të aksionit u informuan mirë se ku ndodheshin çadrat. Pasi ato nuk qenë më se 50-60 metra larg, u treguan partizanëve pozicionet që duhej të zinin dhe i porositën të mos qëllonin para se të hapte zjarr vetë drejtuesi i aksionit.

Filloi të zbardhte drita. Partizanët panë çadrat. Ata kishin formuar një gjysmërrethi përçarktyre. Prisinin me gisht në këmbëzë. Nga çadrat u dëgjuan të folura gjermanisht. Tre vetë, që si duket sapo qenë ngritur nga gjumi, zunë të laheshin para çadrave, ndërsa të tjerët vazhdonin të bisedonin brenda. Kërciti automatiku, pas tij u hap një zjarr i dendur. Të tre ata që laheshin ranë për të mos u ngjitur më kurrë. Vijoi një vrull i rreptë zjarri kundër çadrave. Nga amiku nuk pati asnjë

kundërveprim. Sikur qenë të gjithë në një mendje, partizanët e ndalën zjarrin për disa sekonda. U dëgjuan ulurima të tmerrshme të plagosurish.

Filloi përsëri një zjarr edhe më i dendur se përpara. Fishëkët me zjarr, që u kishin marrë gjermanëve, u vunë flakën çadrave me gjithë të zotët brenda. Edhe kur ra zjarri e tymi e flaka mbuluan lëndinën ku qenë vendosur çadrat, nuk u pa njeri të lëvizte. S'kishin kaluar veç pak më tepër se dhjetë minuta, kur u dëgjua krisma e një bombe dore nga prapa. Ishte shenja e tërheqjes.

Të lehtë e krenarë, me gëzimin e suksesit në fytyrë, u larguan të 25 partizanët. U muar vesh se mbi pesëdhjetë gjermanë kishin mbetur të vrarë e shumë të tjerë ishin plagosur.

Duke u mbështetur në vëzhgimet e veta, në vrojtimit e partizanëve dhe në fjalët e bariut, Karadaku i kishte vendosur forcat në një mënyrë e në një drejtim të atillë sa me një sulm të befasisëm gjermanët të shpartalloheshin në çadra brenda pak minutash, dhe partizanët të mos pësonin as dëmin më të vogël.

LUFTËTAR E PUNËTOR

Ishte pasdita e 9 tetorit 1943. Brigada I S po pushonte në afërsi të Erzenit. Karadaku që ulur rrëzë një ledhi e po bisedonte me një partizan të kompanisë së tretë. Ndërkohë Karadakut i afrohen komandanti e komisar i kompanisë së tretë. Nisën të bisedonin rreth veprimeve luftarake që pritej të kryheshin në afërsitë e Tiranës. Ra fjalla edhe për një major gjerman, që ishte kapur rob në Qafë-Kërrabë.

Disa hapa larg buzës së lumit ishte vendosur çadra e komandantit të brigadës, shokut Mehmet Shehu. Në atë çadër të vogël hynin e dilnin shumë njerëz, ndër të cilët edhe ish-oficerë e nënoficerë italianë.

— Shoku Mehmet është i zënë sot më shumë se çdo herë tjetër, — tha komandanti i kompanisë, pa hequr shikimin nga çadra.

— Ashtu është, — u përgjegj Karadaku. — Përveç drejtimit të luftimeve, ai merret edhe me organizimin e një batalioni me ushtarë italianë, të cilët pas thirrjes që u bëmë, shfaqën dëshirën të luftonin së bashku me partizanët kundër gjermanëve. Kjo është një punë e mirë.

— Për formimin e këtij batalioni ka kohë që flitet, qysh kur u dorzëua divizioni italian në Dibër, — tha komisari i mendueshëm, — po gjer tani ende nuk është vendosur përfundimisht. Ka shumë oficerë italianë që nuk janë të mendimit të formohet batalioni. Megjithatë, batalioni mund të formohet edhe pa oficerë.

— Kjo punë nuk ka pse të na shqetësojë; ajo do të zgjidhet, — vijoi Karadaku, — po unë sot qeshë për punë të komandanti i brigadës dhe e pashë që ishte i zemëruar. Shpejt mora vesh shkaku; ai ishte zemëruar me Xhelal Staraveckën¹⁾, komandantin e batalionit të dytë. Batalioni kishte marrë urdhër për veprim dhe, për faj të Xhelalit, nuk kishte kryer thujse asnjë aksion. Komandanti i batalionit, nga që i kishte bërë bisht luftimit, kishte nxjerrë gjithfarë arësytimesh të kota për të shfajësuar veten. Ai nuk kishte qëndruar në krye të batalionit, nuk e kishte drejtuar atë sipas udhëzimeve të partisë e të komandës së brigadës.

I tretur në mendime, Karadaku heshti ca, pastaj vijoi:

— Shumë keq që një batalion i mirë, siç është ai i dyti, të mos ketë në krye një komandant të vendosur. Përveç kësaj, mua më kanë thënë ata të

1) Ish-oficer i milicisë, i hedhur në rreshtat partizane me qëllime të caktuara sabotimi e spiunimi, dezertoi në nëntor 1943 e u bë komandant i xhandërmarisë kuislinge të Tiranës; qe zbatuesi kryesor i masakrës së përgjakshme të 4 shkurtit 1944, të bërë në Tiranë me urdhër të pushtuesve gjermanë.

batalionit të dytë se Xhelali kurdoherë heshtazi i bën bisht pjesëmarrjes drejt në luftë.

Bisedën e ndërprejnë, se pranë tyre dëgjuan çapat e komandantit të brigadës. Ai kishte dalë nga çadra e u qe afruar. I porositi që ditën tjetër, më 10 tetor 1943, batalioni i parë të nisej në drejtim të katundeve Kryezi e Gurrë, ku do të merrnin udhëzime të reja.

Karadaku nisi menjëherë të kontrollonte gjendjen e batalionit.

Xheladini ishte edhe i pushkës edhe i punës. Në Nivicë kishte pasë bërë almise të forta e të thjeshta si askush në atë vend. Parmendën nuk e kishte ndërtuar një copet, siç e punonin zakonisht në Labëri e në malësitë e tjera përreth, sepse një lis i tillë gjendej me shumë vështirësi në pyll. Ai e kishte pasë mbërthyer prej disa pjesësh, të cilat nxirreshin fare lehtë edhe në një zabel të vogël. Aq me kujdes e mirë i kishte pasë punuar ai almiset, sa kishte mbetur fjala: «E fortë e e lehtë si parmenda e Xheladinit».

Nuk i rrihej pa punë edhe në luftë. Herë pas here riparonte gjerdanët, rrypat e pushkëve ose ndonjë pajisje tjetër.

Gjatë kontrollit vuri re se kafshët e batalionit ishin lënë pas dore, shumë prej tyre ishin zbathur dhe nga udhëtimi nëpër gurë po u prisheshin thundrat. S'do mend ai nuk mund të pajtohej me këtë gjendje. Ja edhe tani gjeti veglat dhe, si një nallban me përvojë, ju vu punës për t'i mbathur kafshët.

Thirri disa partizanë që të shikonin dhe të mësonin.

Rreth e rrotull shumë partizanë të tjerë po e shikonin.

Një shok ju afrua dhe e pyeti:

— Ç'po bën ashtu, Karadak?

— Po bëj gati prapavijën për marshim, — ju përgjegj Karadaku, pa e ndërprerë punën. — Lufta i do të gjitha, edhe pushkën e pastër e të vajosur edhe mushkën e mbathur e të ushqyer.

— Po ku e ke mësuar atë mjeshteri, he burrë?

— Pse, nuk e din, lum shoku, se në Kosovë e në Rrafsh të Dukagjinit çdo gjë bëhet me qerre e kuaj? Bile gati për derë kanë edhe kaloshin. Eh, dikur, kur isha ende fëmijë, po më kujtohet mirë, kam patur një kaloshin që në të tërë krahinën tonë s'e kishte kush më të mirë. E kishte punuar vetë babai për merak. Kishim edhe kalin, Dori e quanin, që kur e mbrehnim në të dukej sikur nuk ecte në taka po sikur fluturonte. Ah, me atë kaloshin i kam braktisë trojet, kur më 1913 xhandarët serbë më dogjën shtëpinë. Eh, jetë, o jetë!.

Si për të kapërdirë atë lëmsh hidhërimi, mprehu mirë e mirë thikën, kapi këmbën e mushkës më të egër e nisi t'i prisë më kujdes thundrat e stërgjatura nga të udhëtuarit zbathur prej disa kohësh.

SULMI I SHPEJTË TË JEP KRAH

Ndër pleqtë e malësive shqiptare dëgjohet kjo porosi: kur të turret qeni, mos ikë, por turrju edhe ti, sepse kur i largohesh i dukesh më i vogël, ndërsa kur i afrohesh i dukesh më i madh. Duke e sqaruar në plan tjetër thonë: kur të sulmon armiku kundërsulmoje; gjoksin ta mbrojnë sytë, ndërsa shpinën s'ta mbron asgjë. Kështu kanë luftuar gjithnjë shqiptarët e këtë e kanë pranuar edhe të huajt. Në vargjet e veta Bajroni thotë:

*Të rrebtë janë bijtë e shqipes
Ç'armik ua ka pa shpinën?..*

Karadaku e kishte ngulur mirë në mendje qysh me qumështin e nënës këtë porosi të trashëguar brez pas brezi.

— Sulmi i shpejtë të jep krah, — kjo ishte porosia e parë që u jepte partizanëve të rinj që i vinin në batalion.

Ai e pat zbatuar këtë disa herë kur ishte në çetë dhe në mënyrë më të dukshme në luftimin që nisi më 8 nëntor 1943 në Graçan të Mallakastrës.

Batalioni, pasi që larguar nga Berati, po marshonte për në thellësi të Mallakastrës. Më 8 nëntor,

ende pa aguar, ai u nis për udhë. Pas më se tri orë udhëtimi të shpejtë u ndal të pushonte në një luginë në juglindje të fshatit Graçan. Partizanët grupe-grupe po çlodheshin. Disa sapo ua kishin nisur këngëve partizane, kur nga kodrat përtej, jo më larg se 300-400 metra, krisën pushkë e mitralozë. Ishte çasti që duhej vepruar shpejt e me guxim. Dhe ja, nga mezi i partizanëve buçiti një zë i fortë e i patrembur: «Përpara partizanë!» Ishte zëri i Karadakut. Në ecje e sipër, duke u dhënë kompanive drejtimin për sulm, vetë me pushkë në dorë, ju ngjiti përpjetë shpatit, përpara, në ballë të batalionit. Sulmi i partizanëve që i rrufeshëm dhe i furishëm. Armiqtë sadoqë qëndruan nuk e përballuan dot sulmin partizan. U thyen. Partizanët, duke sulmuar me bomba dore, ua muarën një nga një pozicionet armiqve. Këta, ndonëse u erdhën në ndihmë forca të tjera gjermano-balliste, nën goditjen e forcave partizane, pas një ditë luftimesh, ikën të shpartalluar drejt Patosit, të ndjekur këmba-këmbës nga partizanët.

NGA PATOSI NË TENDËN E QYPIT

Më 10 e 11 nëntor 1943 Brigada I S çliroi me luftime të ashpra e shumë të përgjakshme dhe mbajti për një kohë një pjesë të Patosit. Në agimin e ditës tjetër, më 12, brigada u sulmua nga forca të shumta gjermane të mbështetura nga artileria e tanket.

Pas një qëndrese të ashpër, partizanët morën urdhër të tërhiqeshin nga kodrat lindore.

Karadaku u dha me shpejtësi vartësve udhëzimet për mënyrën, radhën e drejtimin e tërheqjes dhe vetë qëndroi i fundit në gjunjë, me pushkë për faqe. Karadaku, si i moshuar, mbi 40 vjeç, kishte dhembshuri të veçantë për partizanët, të cilët ishin mjaft të rinj. I mësuar që i ri në luftë komitësh, i vetëm, i djegur për shokë, përpiqej t'i ruante me çdo kusht partizanët. Prandaj prirej të qëndronte në vendin më të vështirë. Qëllonte parreshtur kundër maqinave me ushtarë, që ndaleshin në sheshin përpara. Merrte shenjë me aq gjakftohtësi, sa asnjë plumb nuk i shkonte kot. Kur shikonte që ndonjë gjerman përplasej si shakull për tokë, shtrëngonte dhëmbët e thirrte:

— E pat edhe një!

Edhe pasi forcat partizane u tërhoqën, ai ndejti në pozicion. Një shok, që u ndodh pranë tij, i propozoi që të tërhiqeshin, se nazistët po sulmonin në atë drejtim e kishte rrezik t'i rrethonin.

— Ikë ti përpara, se unë po vij më prapa. — Karadaku nuk luajti nga vendi. Madje nga dufi i urrejtjes për armikun u ngrit edhe në këmbë dhe qëllloi me shpejtësi kundër këmbësorëve gjermanë, që po afroreshin gjithnjë e më tepër.

Duke parë se nuk po i vinte pas dhe krisma e pushkës së tij nuk po dëgjohej, shoku i llogores kujtoi se qe vrarë. Por jo! Ai kishte rënë barkas e priste deri sa armiqtë t'i afroreshin pranë. Vrau dy të parët, pastaj u tërhoq me shumë marifet nëpër një luginë të vogël.

Ja arriti me nxitim praparojës e doli tej në një kodër. Që andej shikonte nazistët gjermanë, që lëviznin togje-togje. Forcat kryesore të brigadës po nxitonin të zinin pozicion buzë kreshtës së shpatit, që ngrihej andej nga lindja. Karadaku ecte ngadalë i fundit, kafshonte buzët e fshante tërë inat me vete:

— Ah, i mjeri unë, të kisha tash një mitraloz!

Edhe pse gjendja nuk e lejonte, nuk ju durua e shtiu prapë kundër tyre. Por e diktuan e disa autoblanda qëlluan njëherësh me breshëri në drejtim të tij.

Se sa i shkathët ishte Karadaku në hetimin, zbulimin dhe vlerësimin e gjendjes e të armikut, dhe sidomos në parashikimin e lëvizjeve të tij, shihet dhe nga vlerësimi i aftësive të tij nga komandanti i Brigadës shoku Mehmet Shehu në librin e tij «Kujtime nga jeta e Brigadës I S». Kur bën fjalë për asgjësimin e kolonës gjermane në Symizë, me

20 nëntor 1943, ai shkruan: «Këshillohemi me Karadaku (nënkomandant i batalionit të parë) dhe me Gjokën e Sazanin (Idriz Seitin), parashikojmë lëvizjen e armikut dhe bëjmë planin ta fusim atë në grackë të mirë.»

Më 13 dhjetor 1943 batalioni i parë sulmoi natën forcat të shumta gjermane të përqëndruara në katundin Vajzë të Vlorës. Karadaku me një pjesë të batalionit sulmoi nga perëndimi. Duke i rënë bilbilit, ai u sul me shpejtësi në drejtim të fshatit. Zëri i tij kumbues «Përpara shokë! Përpara partizanë!» ndihej herë pas here. Forcat naziste, të cilave ua preu rrugën Karadaku me shokë, ndërruan drejtimin, u kthyen e të shpartalluar ikën drejt veriut, duke lënë gjithë materialin luftarak në katund e në rrugën automobilistike. Karadaku, që u tërhoq i fundit, i mbeti shumë merak që nisi shpejt të agonte dita.

— Hej, ç'do t'u kishim punuar tedeskeve, sikur të kishte edhe nja dy orë natë, do të ishte bërë kërdua më rob të gjallë, — thoshte me zemërim ai.

Ndeshjet ballazi me nazistët gjermanë ishin nga veprimet luftarake më të vështira. Ata kishin reparte të veçanta të stërvitura posaçërisht për luftime në male e kundër guerrileve, si i quanin ata në mes tyre partizanët.

Karadaku i përmbahej mendimit se në kushtet e luftës partizane hitlerianët nuk ishin aq të fortë sa i mburrnin.

Ai ishte zotuar përpara komandës së brigadës se bashkë me shokët, në çdo rast të ndeshjes me ta, do t'i thyente keqas forcat gjermane, sado të zgjedhura që të ishin. Dhe rasti erdhi në Tendën e Qypit në mbrëmjen e 20 janarit 1944.

Pas disa ditë luftimesh të ashpra kundër forca-

ve gjermane e balliste në drejtimin Vendreshë-Therepel-Paraspur dhe Bubës-Gllavë, batalioni i parë u zëvendësua nga forca të tjera partizane dhe në mbremjen e 18 janarit 1944 u mblodh i tëri në Zhepovë për të pushuar ndonjë ditë.

Komanda gjermane, e nxitur edhe nga tradhtarët ballistë, zogistë e tradhëtarë të tjerë, synonte të vinte në jetë sa më parë planin e saj për shfarosjen pjesë-pjesë të forcave partizane në krahinat e Skraparit e të Korçës, të Përmetit e të Këlcyrës etj. Një pozicion kyç, që pengonte zbatimin e këtij plani, ishte Tenda e Qypit.

Në kohën që batalioni i tretë i Brigadës I po marshonte nga Dëshnica në Skrapar, me komandantin e brigadës në krye, një kolonë gjermane po drejtohej nga Çorovoda për në Kolonjë. Ndeshja me armikun ndodhi pikërisht në Tendën e Qypit. Me forcat e batalionit të tretë dhe një pjesë të grupit të Skraparit shoku Mehmet Shehu e mbylli me shpejtësi këtë drejtim. Partizanët zunë pozicione me ngut. Armiku kishte grumbulluar përballë forca e mjete të shumta.

Duke hedhur në sulme të njëpasnjëshme forca të freskëta, armiku mundi të pushtonte kodrat e Nishicës e të rrezikonte Tendën e Qypit. Komandanti i brigadës udhëhoqi vetë luftimet e batalionit të tretë, i cili tri herë me radhë kundërsulmoi furishëm armikun deri në përleshje trup me trup. Trimëria, guximi, vrulli revolucionar në sulm nuk mungonte, por duheshin forca për të ndryshuar gjendjen. Prandaj dërguan korrierë në batalionin e parë, në Zhepovë, rreth pesë orë larg. Me të arritur këta e me të marrë urdhërin, Karadaku dha sinjalin e bren-

da 10 minutave forcat e batalionit u grumbulluan në krye të fshatit, të gatshme për veprim. U nisën pa humbur kohë. Partizanët, të prirë nga Karadaku, marshuan me shpejtësi. Komandanti i brigadës priste me padurim. Posa e pa Karadaku duke dalë në qafë, ai s'u përmbajt dot nga gëzimi e thirri:

— A mbërriti batalioni i parë?

— Si gjithnjë batalioni i parë është gati të hidhet në sulm, shoku komandant, — u përgjegj Karadaku e nderoi me grusht.

Çastet ishin shumë kritike, koha nuk priste. Komandanti i brigadës i tregoi Karadakut menjëherë detyrën në vend. Qe punë sekondash. Karadaku doli në qafë e me zë të ashpër, por të qetë e të prerë, pa nervozizëm, duke treguar me dorë drejtimet dha udhëzimet:

— Kompania e parë të sulmojë majtas, drejt shpatit të pyllëzuar, kompania e dytë djathtas, drejt kurrizit të shpatit, kompania e tretë të dalë në majë e të zërë pozicione! — Pastaj e ngriti zërin e thirri me shumë forcë: — Përpara, në sulm, shokë partizanë! Përpara! — Dhe duke i rënë bilbilit, u nis vetë në krye të kompanisë së dytë.

Në të dy drejtimet luftimi u ndez me furi. Partizanët trima u vërsulën si rrufeja dhe me hov të pandalshëm e me bomba dore ju hynë gjermanëve në pozicione. Këtu Karadaku u tregua jo vetëm trim, por edhe ushtarak i zoti, në kuptimin e plotë të fjalës, organizator i shkathët dhe drejtues i aftë i luftimit. Duke zbatuar me mjeshëri taktikën e luftës partizane në tokë të thyer, ai nxori një pjesë të kompanisë së parë fshehtaz e të maskuar pas shpinës së gjermanëve, rreth 2 km. larg. e i sulmoi në befasi

në vendqëndrimet e tyre, në afërsi të vendkomandës. Atje përleshja nisi fytafyt. Duke kombinuar me mjeshtëri në kohë e terren sulmin pas shpine të forcave të kompanisë së parë me ndeshjen ballazi të kompanisë së dytë, duke parashikuar drejt edhe kundërmanovrën e gjermanëve, ai u mbylli nazistëve gjithë shtigjet, i shpartalloi e u kallu datën. Luftimi vazhdonte me vrull të furishëm. Partizanët tashmë kishin futur forcat gjermane në darë të hekurt zjarr, që sa vinte e shtrëngohej. Nazistët që u shpëtounin plumbave iknin duke uluritur si çakenj. Shpejt nisi të bjerë muzgu. Komandanti i brigadës urdhëroi të ndërpritej sulmi. Gjatë kësaj përleshjeje të forcave të batalionit të parë, që vazhdoi rreth një orë, armiku la në fushën e luftimit shumë të vrarë, 3 mitraloza, 4 bateri topash e mortajash, 70 mushka të ngarkuara e shumë materiale të tjera luftimi.

Gjermanët e shpartallur e ndalën trokun në Çorovodë.

Në kreshtën e qafës së Tendës së Qypit, Karadaku dhe Ndreko Rino kishin qëndruar vetëm një hap larg njëri-tjetrit e po vrojtonin fushën e luftimeve. Nuk ishte ndonjë pamje tërheqëse. Por, si gjithnjë pas çdo luftimi, po shqyrtonin ecurinë e veprimeve.

Në fillim gjermanët hodhën disa predha andej-këndeje. Me sa dukej saktësonin qitjen. Pastaj e dëndësuan zjarrin: filluan pregatitjen e artilerisë. Nga pozicionet e zjarrit të nazistëve shiheshin shtullungat e tymit, pastaj, duke ushtuar luginave, vinte jehona e krismave. Mbi kokë dëgjoheshin njëra pas tjetres fëshkëllimat e predhave, të cilat çanin ajrin e përplaseshin atyre shpateve, ku pak më parë

shumë nazistë kishin lënë për jetë kokallat, ndërsa të tjerët ua kishin mbathur këmbëve për të shpëtuar lëkurën. Ata kujtonin se po hakmerreshin, por shpatet e larta vigane as që e ndjenin, as që donin t'ja dinin për ato plasje. Partizanët, kundër të cilëve shfryhej inati, pikërisht në ato shpate ishin strehuar jo keq. Papritmas u dëgjua një fishkëllimë e prerë. Karadaku ndjeu rrezikun.

— Lamtumirë, Ndreko, — i tha ai shokut pranë, i cili nuk e kuptoi atë çast shakanë e tij të hidhur dhe i hodhi një vështrim pyetës. Por nuk qe koha për shpjegime. Aty pranë u ngul në tokë një predhë. Vetëm fletët e stabilizatorit i mbetën jashtë si mustaqe miu. Kapsolla e kuqrremtë, si ndonjë sy magjik, dukej sikur i shikonte vëngër. Disa pika balte ua spërkitën fytyrat.

— Shpëtuam, Ndreko, largohemi që këndeje, — tha Karadaku.

— Oh, jo, — ja priti Ndreku duke qeshur, — aty ku bie një predhë, zakonisht rrallë ndodh që të bjerë edhe e dyta.

— Tamam, mirë e ke, ashtu është! Ndonëse ka kuptim tjetër, po edhe rrufeja, thonë, nuk godet dy herë në një lis.

Shikuan disi habitshëm njëri-tjetrin. Nuk po u besonin syve. Vështrimin e ndalën tek predha e paplasur, që s'ishte më tepër se dy gjurmë larg. Fletët e zeza si të stërgjatura të stabilizatorit tregonin se pradha ishte e madhe, e fuqishme.

— Ç'që kjo hata? — tha me zë të ulët Karadaku, duke shikuar bishtin e predhës së paplasur të ngulur përgjysmë në dhé. — Kujtova se na groposi.

— Po të kishte plasë, s'do të na kishte mbetur

as nam e as nishan, — tha Ndreku. — Ndodh shpesh që nuk pëlcastin, janë të sabotuara, — tha Ndreku. — S'ka dyshim se një dorë proletari që ajo që na shpëtoi nga kjo bolbë e shpikur nga mendja e njeriut vetëm për të vrarë. Tërë ajo forcë e mbyllur në atë guaskë të zezë çeliku heshti, sepse diku dora e proletarit enkas nuk e ka vënë kapsollën ose rrahësin e djegores në vendin e vet. Është parulla e madhe e komunistëve: «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!»

— Eh, — mërmëriti Karadaku, — jo kot ne e këndojmë përherë këngën:

*O proletarë, kudo që jini,
Fashizmit bini, fashizmit bini!*

Zërin e tij e mbuloi gjëma e disa plasjeve buzë kreshtës. Flaka ndriçoi për në çast gjithë kurrizin e qafës. Tashmë nata po e mbulonte anembanë dheun.

Me urdhër të komandantit të brigadës, batalioni u tërhoq në drejtim të malit të Toroninës.

Karadaku qëndroi praparojë. Si u larguan forcat kryesore partizane, ai si lëshoi shpatit një breshëri kositëse mitralozi dhe u nis pas gjurmëve të forcave të tjera.

Diku tietër në mbledhje të batalionit, duke ju drejtuar partizanëve dëshmorë Sulo Buxheli e Ago Topulli, që në kacafytje me armiqtë kishin larë me gjakun e tyre ato shpate malesh e u kishin dhënë ngrohtësinë e zemrave të veta. Karadaku tha vetëm këto fjalë: «Partizanë trima! Gjaku juaj nuk humbet kurrë! Do të bjerë shiu e s'do ta lajë, do të bjerë dielli e s'do ta thajë! Ai do të shpërblehet me çlirimin e plotë të atdheut tonë të dashur, të Shqipërisë!»

ASGJË TË MOS I LËMË ARMIKUT

Karadaku ishte muçkërr i armëve e i pajisjeve luftarake. Ai tregohej fort i rreptë për ruajtjen qoftë edhe të sendit më të vogël që i duhej partizanit. Kur ishte komandant çete, ai e kishte mbajtur vetë mitralozin. Në brigadë veç armëve mbante edhe një tagan e në mot të keq një shkop të gjatë alpin. Karadaku, si mjeshtër armësh, mbante edhe një shtojcë për hedhjen e bombave të dorës me pushkë, një gyp në formë hinga, që asnjë partizan tjetër nuk e mbante. Këtë, me shaka, shokët e quanin «hinga e Karadakut».

Në luftimet në Qafën e Rërësit, në juglindje të Patosit, duke kapërcyer në një gardh, i ra «hinga» që e ruante me mjaft kujdes e që e quante mortajë dore. U kujtua për të pasi kishte bërë disa minuta rrugë.

— Ecni drejt, përpara e djathtas, unë po kthej pakëz, se më ka rënë hedhësja e granatave. Me siguri do të më ketë rënë kur kapërceva një gardh.

— Tha këto e u zhduk si era, pa ua vënë veshin kundërshtimeve të shokëve, që nuk donin të kthehej.

Eci me vrap. Kur ju afrua gardhit, një ballist po kalonte në kapërcyell. U takuan ballë për ballë.

Sytë e zgurdulluar të ballistit nuk i qëndruan dot shikimit të rreptë të Karadaku. Ky, me shpejtësinë që e karakterizonte, ktheu pushkën e pa e vënë në sy e shtriu ballistin shakull përdhe, me krye në gardh. Ballistët e tjerë, që i vinin pas, kujtuan seranë në pritë partizane e ua mbathën me të katra prapa. Karadaku e gjeti hingën dhe u kthye shpejt te shokët. Krisma e një pushke të vetme i kishte shqetësuar shumë. Disa, me ta dëgjuar, ishin turrur pa frymë në atë drejtim.

— Si rrezikove veten për një copë teneqe, bre Karadak? — i thanë shokët.

— Asgjë të mos i lëmë armikut. Po t'i lësh një herë hingën, herën tjetër i lë gjerdanin, të tretën pushkën, pastaj e ul kurrizin që të të hipin në shpinë, të të bëjnë shërbëtor ose të të marrin shpirtin, si të kenë më leverdi. Unë kam qenë shumë kohë argat e shërbëtor, ja kam pirë hurrën asaj pune. E di, pse i njoh, si do të lanin ata lesh në ne po të mundnin. Prandaj nuk duhet të lëmë asgjë, qoftë edhe sa grimca. Po ta kishin gjetur ata hingën do të mburreshin: «Shih, edhe armët i kanë hedhur gjerdheve duke ikur», do të thoshin për ne. Pra më mirë të lënë ata kokën gjerdheve, se sa të mburren me gjërat tona, qoftë edhe krejt pa rëndësi.

Edhe pse partizanët nuk ja pëlqyen këtë veprim, ai nuk u dëshpërua. I qeshur e i dashur u fut në mes të tyre e u nisën me nxitim për marshim, për të kryer një detyrë të re mjaft të rëndësishme.

Duke qenë se për disa kohë kishte bërë jetën e komitit, Karadaku prirej shpesh për të vepruar më pak vetë ose fillkat vetëm.

I RREPTË, I DASHUR E I DREJTË

«Njëherë, — kujton një shok i tij, — pas një luftimi, për fajin tim ndodhi një farë grindjeje midis dy komandave të kompanive. Njëra kishte marrë pa ditur e padashur furnizimet e caktuara për tjetrën, që ishte më e madhe në numër. Kur u diktua gabimi, materialet u ishin shpërndarë partizanëve e komanda e kompanisë nuk donte t'ua tërhiqte përsëri. Tjetra ngulte këmbë në të vetën. Kështu punën duhej ta zgjidhte komanda e batalionit. Karadaku më thirri në çadër e më foli me aq ashpërsi, sa kujtova se sytë po i nxirrnin shkëndija. Ndërsa po më qortonte rëndë, por me të drejtë, isha mpirë fare e po me doja si të shpëtoja nga ky njeri kaq i rreptë. «Mbase tërë jetën do të më urrejë, do të qëndrojë kështu i vrazhdë», bluaja me vete. Ai i mbaroi ato që kishte menduar të më thoshte dhe, duke ndryshuar krejt çehren, më tha me të butë: «Shko në kompani, kujdesu si janë vendosur partizanët. Nga e vona eja të shohim bashkë rojet». Nderova me grusht e u përkula pakëz për të dalë nga çadra. Atë çast dëgjova pas shpine së si i tha shokut përbri tërë kënaqësi e entuziazëm: «Ama djema janë këta të kësaj kompanie! Me ta njeriu s'gjen kurrë mort. Si petrita u hodhën mbi tedeskët, lanë lesh më ta. Mos i foli pak si rëndë? E

kam hallin se grindja më e vogël prish unitetin». Duke mbërthyer fletën e çadrës, në të dalë i hodha një vështrim. Vura re se po më shikonte me aq dashuri sa kurrë në jetë s'më ka përcjellë kush me sy kaq të dhimbshëm e të përmallshëm. Më gufoi zemra, më kaloi tërë të mpiririt që më kishte pushtuar e gjithë gëzim shkova të shokët.»

Karadaku kishte nderim të madh për shokët. Në asnjë rast nuk donte të dukej. Një natë, pas një mbledhjeje në Vërzhezhdë, batalioni i parë u shpërnda për të pushuar në fshatrat e Tomorricës. Komandant batalioni sapo ishte caktuar shoku Ndreko Rino, i cili deri atëhere kishte qenë komandant i kompanisë së tretë të atij batalioni. Bashkë me Karadakun ai shkoi në një shtëpi për të bujtë. Me qëllim që Karadaku të ulej në krye të vendit, Ndrekuua enkas u vonua duke zhveshur kapotën e duke hequr gjerdanin. Karadaku priti në këmbë. Ndrekuua e vuri re. Meqenëse ishte më i ri në moshë dhe e kishte pasë Karadakun dhe epror në detyrë, i tha:

— Ulu, shoku Karadak, ty të takon, je më i madh në moshë e pastaj edhe më i vjetër në udhëheqje të batalionit.

— Po, — ja priti Karadaku me çiltërsi, — mirë po flet, veç tani ti je babai i batalionit. Ne sot jemi luftëtarë dhe e nderojmë njeriun sipas detyrës, sipas përgjegjësisë që mban në luftë. E në luftë moshë shpesh nuk bën aspak ferk. Një fjalë e moçme popullore thotë: burri dallohet nga veprat e jo nga vjetëti. — Karadaku, plot dashuri vëllazërore, e kapi Ndrekon për dorë, bëri pak anash e i lëshoi rrugë të ulej në anë të oxhakut.

TAKIMI NË BARGULLAS

Jeta e rëndë prej muhaxhiri, argati e shërbëtori, zgjedha kombëtare e shoqërore, jeta e komitit, nuk kishin si të mos linin gjurma në karakterin e Karadakut. Ai kishte dhëmshuri të veçantë për popullin fukara e sidomos ndaj fëmijëve sillej si babë i vërtetë.

Duke u gdhirë dita e 9 shkurtit 1944 partizanët e Brigadës I S. rrethuan e asgjësuan bandat balliste në zonën Novaj-Nishovë-Bargullas. Sulmin mbi Bargullas partizanët e filluan që në ora katër të mëngjezit. Pas një qëndrese të shkurtër ballistët gjetën një shteg të verbër e ja mbathën poshtë pyllit. Sapo zbardhi drita, Karadaku, në krye të batalionit, hyri në një lagje të Bargullasit. Po ecte vetë i treti nëpër një rrugë të ngushtë të rrethuar me gjerdhe. Po vrojtonte tërë kujdes shtëpitë e megjet. Befas ndeshi një fëmijë të imtë nga trupi. Karadaku u habit se si në mes të plumbave kishte dalë nga shtëpia ky vocrrak. Si nuk kishte frikë? Ju afrua e me zërin e tij kumbues e përshëndeti:

— Vdekje fashizmit, pionier! — dhe e nderoi me grusht.

— Liri popullit, shoku partizan! — ju përgjegj

fëmija, që e nderoi gjithashtu me grusht e u mundua të merrte njëfarë drejetqëndrimi.

— Qenke pionier i vërtetë, — i tha Karadaku, i cili u kërrus pakëz, i dha dorën si një burri të madh, pastaj e përkëdheli e e përqafoi me dashuri. Në atë çast sigurisht ju kujtua i biri, Avdiu i vogël, që tash po shkelte për të tri vjetët, e, s'do mend, ecte e fliste. Me siguri edhe ai atje në Stok të Nivicës dëgjonte të shtënat e pushkëve. A thua del e pa të keq mbledh gëzhojat?

— Pa më thuaj, biri im, ku e ka shtëpinë kryetari i këshillit? A e di kush janë në këshillë?

— Po si jo, është edhe babai im, hajde të shkojmë, ja ku është shtëpia, — ju përgjegj pionieri e me shkathtësi e kapi Karadaku për dore, si për ta tërhequr lart. Kradaku ja hoqi dorën në qafë e ashtu të dy hynë në shtëpinë e parë mbi rrugë. U takua e bisedoi me të jatën e fëmijës, kryetarin e këshillit nacionalçlirimtar të fshatit. Si sqaruan disa çështje rreth gjendjes në katund, Karadaku i tha:

— Merr armën, shoku Gorezi, e dalim, koha s'pret, duhet ta spastrojmë sa më shpejt katundin nga mbeturinat e armiqve.

— Oh, kam edhe unë pushkë, — tha pionieri dhe iku me vrap. Sa çel e mbyll sytë ai u kthye në dhomë me një pushkë të shkurtër në dorë dhe gjerdanin me fishekë në krah.

— Pushkën po e marrim ne, — i thanë partizanët me shaka pionierit, — ti je ende i vogël, s'ka ç'të të duhet, nuk mund të luftosh me të.

— Oh, jo! Më mirë vij edhe vetë me ju. Pushkën nuk e jap, — u përgjegj pionieri i zemëruar dhe, si duke dashur të mbrohej, u largua disa hapa

nga partizanët. — Edhe unë i luftoj ballistët. Këtu në lagjen tonë asnjë nuk erdhi, unë dola që herët të shoh se ku ishin futur ata kusarë, — tha rëndë-rëndë pionieri e e ktheu pushkën në dorën tjetër.

— A e shikoni? — ju drejtua Karadaku partizanëve. — Edhe fëmija është gati të luftojë, edhe fëmija e don dhe e ndihmon Luftën nacionalçlirimtare, edhe fëmija i urren ballistët, fundërrinat e kusarët e tjerë në shërbim të pushtuesit. Jo, jo, pushkën s'ta prek kush, rritu edhe pak e do të vish me ne. Atëhere Shqipëria do të jetë çliruar patjetër. Ti do të kesh fatin e mirë të mësosh përdorimin e armëve jo si ne, në fushën e luftimit, në gërxhet e shpatet e maleve, po në shkollë, të bëhesh oficer me shkollë 1).

— Hajt, mirë u pafshim, shoku pionier, mbaje pushkën fort në dorë e qëllo armiqtë rreptë! — i dha dorën e mandej e mori ngrykë. Karadaku e përqafoi me aq dashuri atërore, sa ish-pionierit i ka ngelë e pashlyeshme në kujtimin e tij fytyra e ashpër në pamje, po e dashur e e përzemërt e Karadaku. Dhe këtë dashuri atërore Karadaku e tregoi në kohën kur përreth kërciste pushka, pasi gjithë natën e ftohtë e të gjatë të shkurtit kishte ndenjur në pritë me pushkë në dorë! E jo vetëm kaq. Gjatë natës ai kishte kontrolluar në disa drejtime vendosjen e partizanëve në pozicione e gatishmërinë e tyre për sulm.

1) Ish-pionieri i Bargullasit, Neki Gorezi, me të cilin u takua Karadaku, sot është oficer.

SHQIPONJAT FLUTUROJNË MALEVE

Ishin ditët e fundit të shkurtit 1944. Tri batalione të Brigadës I kishte katër ditë që po suleshin drejt Veriut, duke kapërcyer vështirësi të pashembullta luftimi e të natyrës. Brigada arriti në krahinën e Librazhdit. Karadaku vajti tek një shtëpi dhe kërkoi të merrte me vete ndonjë fshtar për t'u treguar rrugën. I zoti i shtëpisë, një burrë i moshuar me qëndrim të lëkundshëm, duke vënë re nga të folurit se Karadaku nuk ishte prej Jugut, me qëllim që ta ngacmonte, e ndoshta ta provokonte, ju drejtua me këto fjalë:

— Mirë se këta toskët e kanë marrë të gjithë këtë rrugë, po ti, gegë, ç'ke dashur me ta?

— Qenke burrë i thyer në mot; thinjat e bardha e kanë hijen e vet. Megjithëse më ngacmove në derën e shtëpisë sate, e miku në shtëpi të shqiptarit nuk ngitet, po të jap një farë përgjigje. Ne atje, në krahinën tonë, në Rrafsh të Dukagjinit, në Kosovë, kemi një fjalë të urtë që thotë: shqiptet fluturojnë maleve e sorrat gardheve. Këtë fjalë e kam dëgjuar edhe këndeje, edhe në Labëri e gjetkë.

— Po, edhe këndeje e përdorin, — foli me dyshim i zoti i shtëpisë.

— Më është mbushur mendja top se një ditë jetë shqiponje vlen më shumë se njëqind vjet jetë sorre. Kjo është një arësye. E dyta e them me bindje, plot gojën, se këta djem janë shqipe të vërteta. E shqipja fluturon maleve, shijon freskinë e ajrit të pastër ndjen gazin e jetës së lirë. Edhe unë pleqnova sa pleqnova me vete, shikova shqipet kah çanin maleve, pa shë edhe sorrat si kërrisnin gardheve duke shkërmuar ndonjë cofinë që u hedh i huaji. M'u mbush mendja rrumbullak se është më burri të shkoj me shqipet e lira maleve se sa të kërras gardheve me sorrat. Pra, edhe pse pak i kaluar në moshë, ndoqa rrugën e rinisë, të këtyre petritave. Kështu mendova e kështu veprova. Ma thotë mendja se s'kam vepruar keq. Ndoshta ti e quan gabim mendimin tim. Por, si shqiptari shqiptarit, po ta them mu në derën tënde: faqebardhë sorra s'del kurrë ajo, është e zezë, pra e bardhë s'bëhet. Kështu qëndron puna!

Katundari kapërdiu pështymën dhe shikoi rreth e rrotull. Desh të thoshte diçka, por, me sa duket, e pa veten ngushtë e, pasi nuk gjet kund mbështetje, e pa më të udhës të heshte, të mos përgjigjej fare.

DIKUSH LUFTON ATJE!

Gjatë inkursionit të të tri batalioneve të Brigadës I, në shkurt-mars 1944, në Qarrishtë, ato u gjetën në kushte shumë të vështira rrethimi. Unaza e rrethimit që e dyfishtë: nga malet e larta, me një e me dy metër borë, dhe nga forcat gjermane e balliste, që e sulmonin brigadën nga të katër anët. Në praparojë që caktuar një kompani. Por në Qarrishtë, në këtë gropë malore, që dukej si ndonjë kazan natyral, komandanti i brigadës, duke e vlerësuar gjendjen si mjaft të rëndë e të ndërlikuar, urdhëroi të qëndronte edhe Karadaku me një skuadër, që të priste praparojën, të bashkohej me të dhe të drejtonte veprimet e saj luftarake të mëtejshme. Forcat gjermane e ndiqnin brigadën pas gjurmëve. Gjermanët synonin ta arrinin me çdo kusht brigadën e, si ujçer të tërbuar, të vërtiteshin mbi forcat kryesore të kolonës partizane. Karadaku priti e priti. Nga të gjitha anët forcat balliste, që ishin struktur në katund, po e shikonin si hiena koskën. Mateshin ta goditnin, po nuk guxonin, sepse forcat kryesore të kolonës partizane ishin ende afër e gjermanët nuk po ndiheshin. Pra, prisnin çastin më të volitshëm. Karadaku i shikonte e nuk tundej. Ai qëndronte i

qetë dhe pa i përfillur fare ballistët. Priste orë e çast ardhjen e praparojës. Veç dhjetë partizanëve të një skuadre që kishte mbajtur, me të u bashkuar edhe disa partizanë të mbetur pas nga batalionet. Kështu që u bënë gjithsejt njëzet vetë. Gjendja ishte e acaruar. Mbi treqind ballistë me pushkë e mitralozë, të vendosur nëpër frëngjitë e shtëpive, rrinin gati të sulmonin partizanët pabesisht.

Karadaku vëzhgoi rreth e përçark. Ai vuri re se ndërsa gjermanët po shtinin me mitralozë kundër forcave të praparojës, dy ballistë po i suleshin Zenel Ormenit, që t'i merrnin mitralozin. Zeneli, i qetë e i matur, u tha ballistëve:

— Mos bëni marrëzira, mitralozin ka kohë që e mbaj për të luftuar kundër pushtuesve e tradhëtarëve, këtë veç me grykë, se me qytë nuk ja nap kuj!

Ballistët, të krepatur nga afrimi i gjermanëve, nuk ja vunë veshin fjalëve të partizanit, por me mendjemadhësi e egërsi shtazarake, duke sharë, ju vërvitën t'ja merrnin armën. Zeneli u dha një breshëri të shkurtër e u plasi mullën katilëve për tokë. Dy tradhëtarët ishin dërguar nga shokët e tyre, të cilët nga frëngjitë e larta të shtëpive e kishin studjuar parreshtur gjendjen. Mitralozin e Zenelit e kishin vlerësuar si armën më të rrezikshme për ta. Prandaj, përpara se të nisnin pushkën kundër partizanëve, kishin menduar të zhdoknin me pabesi mitralozin e kështu kishin dërguar dy nga më të pabesët e më dinakët që ta kapnin tradhëtisht mitralierin. Pasi u dështoi plani i tyre djallëzor dhe gjermanët kishin hyrë në katund, ballistët faqezez nisën sulmin e pabesë dhe goditën tradhëtisht pas shpine forcat e praparojës. Në çast

Krisën pushkë e mitralozë nga të katër anët. Nga çdo frëngji, dritare, derë e megje ballistët villnin parreshtur zjarr kundër partizanëve, ndërsa gjermanët suleshin nga pas si bisha të vërteta. Në këtë gjendje kaq kritike i vetmi veprim i drejtë ishte për partizanët të luftonin me këmbëngulje.

Duke e kuptuar e duke e vlerësuar drejt gjendjen, Karadaku vendosi të luftonte aty deri në pikën e fundit të gjakut. Ndau forcat në tri grupe të vogla luftimi. Ndonëse në kushte shumë të rënda, i udhëzoi partizanët si të vepronin e si të çanin përpara. Forcat kryesore ishin thuajse larguar, e kishin kaluar rrezikun e rrethimit në kazanin djallëzor të asaj grupe në mes të maleve të stërngrysura me bore. Por «në Qarrishtë vazhdon lufta me furi, dikush lufton atje, sigurisht partizanët e praparojës dhe Karadaku (nënkomandant i batalionit I) bashkë me ta, që mbetën të rrethuar nga të gjitha anët e luftojnë si luanë që të gjithë, deri sa dhanë jetën e tyre të shtrenjtë, përveç Karadakut e disa të tjerëve që mundën të shpëtojnë» 1).

Rreth Karadakut e shokëve të tij, të ndarë në tri grupe të vogla, sa vinte e ngushtohej gjithnjë e më fort unaza e zjarrit e rrethimit. Por ata qëndronin, luftonin që të shpëtonin brigadën.

Qarrishta dukej sikur ishte në flakë. Krismat përziheshin me jehonën e vet, e cila rrotullohej shpateve si një gjëzim i pandërprerë; dukej sikur toka dridhej parreshtur. Vonë, gati buzë mbrëmjes, Karadaku nisi të lëvizte majtas, me qëllim që të delte nga rrethimi. Vëzhgoi me kujdes gjithë sinorin dhe

1) Mehmet Shehu «Kujtime nga jeta e Brigadës I S.» Ibot. II, Tiranë 1959, f. 28.

parashikoi drejtimin e lëvizjes. Larg, diku lart në malin e Letmit, partizanët po çanin me heroizëm. Karadaku vëzhgonte nga afër armiqtë, që i kishte fare pranë, por mendja i shkonte atje larg, tek ndiheshin të shtënat e shokëve, që tashmë mezi dëgjoheshin.

Ecte sa ecte, ndalej, vëzhgonte, qëllonte e pastaj përsëri ecte. Kështu vazhdoi një copë rrugë.

Të shtënat, si përreth, ashtu edhe në malin e Letmit, nisën të pakësoheshin. Filloi një pezmi i madh të ftohti që të këpuste. Ndërsa po ngjitej shpatit, një roje gjermane e pikasi nga larg. Një plumb i fishkulloi pranë veshit. Eci edhe një copë herë mpijtas deri sa doli në një bregore pak si të mbrojtur. Që andej dukej një kundrajë mjaft e gjerë. Po binte muzgu. Nga lodhja e acari frymëmarrja i qe rënduar shumë. Bula djerse i rrëshqisnin nga fytyra e binin mbi borën e akullt. Koka i nxirrte avull, tym. Muzgu po mundohej të errëson-te hapësirën e bardhë. Të shtënat pothuajse kishin pushuar fare. Vetëm nganjëherë më të rrallë, ndonjë plumb i ftohtë i fishkëllonte mbi krye. Qëllonin diku andej nga larg.

Hodhi sytë rreth e përçark: kudo heshtje, acarrim e thëllim. U kthye me fytyrë nga Qarrishta. Kujtonte shokët e rënë. Ngriti dorën grusht e ndërroi. Era e ftohtë përplasi në shkëmb zërin e tij kumbues: «Betohemi se do t'ua marrim hakun!» Qëndroi një copë herë ashtu pa lëvizur, por mendja diçka i bluante. Çfarë mendonte, vallë, ky luftëtar në ato çaste buzë asaj bregoreje, i vetëm në mes të pyllit me borë, i rrethuar nga çdo anë nga armiqtë? Mos ndoshta ai bënte një betim të ri?

Ngriti kryet e pa! Po ç'të shihte! Veç ahishtes shekullore, tej e mb'anë hapësirë e ngrirë me borë të pajetë e atje larg, ku kishte gjallëri, armiqtë e asgjë tjetër! Fshiu djersët, vuri pushkën në krah, u rrgjit në një shkëmb e vëzhgoi.

«Ku do të jenë shokët? Përpara, lart në male», — tha me vete. Për herë të parë në jetë e ndjeu veten ngushtë: vetëm, në mes të maleve që s'i njih-te. Por s'u dha. «Shokët diku luftojnë — mendoj. — Po unë?.. Edhe unë duhet të luftoj për të shpëtuar ose të vdes duke luftuar, kjo është detyra ime».

RAVGIMET PAS QARRISHTES

Karadaku nderi një cigare, e thithi me forcë dy-tri herë dhe e flaku në borë. Ajo ra me bisht dhe nuk u shua. Tymi shkante drejt. Nata tashmë mbuloi dhenë. Vëzhgoi edhe një herë rreth e për-qark. Majat e maleve zbardhnin si piramida viganë. Atij ju kujtuan fjalët që thoshte shpeshherë komandanti i brigadës: «Mali është aleati shekullor i shqiptarit». Ato i dhanë zemër. Eh, po, shokët diku po çajnë maleve si shqipe të vërteta. Vendosi të ecte shpatit të malit, majtas, në drejtim të veriperëndimit. Pas disa orësh udhëtimi u ndal e pushoi në zgavrën e një ahui të stërlashtë. Ditën tjetër e nxorri rruga përballë një katundi, Llëngës.

E kundroi për shumë kohë fshatin. Si e shoshiti mirë e mirë gjendjen, ja vuri syrin një shtëpie, e cila nga lëvizjet e shumta ju duk si shtëpi e madhe, pra e fortë. Por ama tani e kishte pleqëruar vendimin e marrur buzë bregores, e kishte prerë: «të luftoj për të shpëtuar ose të vdes duke luftuar, rru-gë tjetër s'ka». Me këtë mendim të prerë u nis të hynte në fshat. Deri në oborr të shtëpisë ku vendosi të drejtohej arriti pa e vënë re kush. Aty thirri sipas zakonit:

— O ti, i zoti i shtëpisë, a pret miq?

— Hajde, bujrum, — u dëgjua një zë nga brenda.

Karadaku hyri dhe u gjend ballë për ballë me një burrë të thyer në moshë rreth të gjashtëdhjetave, armatosur më së miri.

— A ke besë shqiptari? — i drejtohet dhe e pyet Karadaku.

— Si jo, shqiptar jam e besë kam! — përgjigjet burri, dhe habitet për një pyetje të tillë në shtëpi të vet. Ai si burrë pushke e bese njihej në të gjithë krahinën.

— Jam partizan, dje në Qarrishtë mbeta i rrethuar, dola prej rrethimit vonë e nuk i arrita dot shokët, tani nuk e di se ku janë. Dua t'i arrij patjetër.

Sytë e tyre i kryqëzuan vështrimet për një copë herë. Në fytyrën e Karadakut nuk vihej re as frikë, as tronditje. Ai dukej burrë, shqiptar azgën. Nga qëndrimi e pamja e Karadakut i zoti i shtëpisë uli sytë e, duke i mbajtur pushkër, i tha:

— Qenke trim e besnik i detyrës sate, e për trimat e besnikët ka gjithnjë vend në votër të shqiptarit!

I zoti i shtëpisë e donte me shpirt dhe e quante të tijën Luftën nacionalçlirimtare; ai e mbajti Karadakun në shtëpi deri të nesërmen në drekë. Sipas fjalëve që përhapeshin, u muarr vesh se partizanët kishin kaluar në Mat. Në atë drejtim e përcolli ai Karadakun deri sa e nxori jashtë krahinës shëndoshë e mirë. Rrugës Karadaku u ndesh edhe në disa partizanë të tjerë e në ditët e para të marsit arriti në Krye të Matit, ku takoi një numër partizanësh të

sëmurë të Brigadës III S. Qëndroi me ta disa ditë. Por nuk i rrihej, nuk i zinte vendi vend pa shokët. Me partizanët e shkëputur e të sëmurë ai krijoi një çetë të vogël. Me ta u vu në kërkonte brigadën, duke e ndjekur hap pas hapi.

Në afërsi të Erzenit u takua me partizanët e Batalionit «Dajti». Ata e informuan mbi gjendjen dhe sipas të dhënave të tyre zgjodhi shtegun afër Petrelës e kaloi pa rrezik rrugën automobilistike Tiranë-Elbasan. Kur vajti Karadaku në Pezë, Brigada I sapo ishte larguar. Edhe Karadaku fill pas brigadës i gjarpëroi rrethimit armik, kaloi me grupin e vet Shkumbinin e doli në Dumre. Deri në këtë kohë Karadaku mendonte si e si ta arrinte brigadën, duke ju shmangur ndeshjes me armikun, ndërsa tani, pasi kaloi Shkumbinin e partizanët e sëmurë e ndjenin veten më mirë dhe efektivë i grupit ishte shtuar, nisi aksionet. Afër Belshit ndaloi e dogji një veturë ballistësh. Pas tri ditësh në Gostimë u zuri pritë tri makinave gjermane të furnizimit. Pritën e zuri me aq mjeshteri sa me të shtënat e para të tri makinat u ndalën përnjëherësh në vend. Si u asgjësuan shoqëruesit, partizanët morën sa deshën bukë e ushqime dhe pastaj u vunë zjarrin makinave. Ndërsa Karadaku ndodhej në Gostimë, jo shumë larg shokëve, komandanti i brigadës njoftonte Shtabin e Përgjithshëm se «për ata të Qarrishtës kemi këto lajme nga partizani Bektash Dalipi nga Bargullasi... Ky na thotë se kishte dëgjuar prej njerëzve të Haziz Biçakut, se një komandant (na duket Karadaku) ka mundur të shpëtojë...» 1) Nuk vonoi dhe për aksio-

1) Brigada I S. e UNÇSH, Tiranë 1963, f. 348.

nin e Gostimës mori vesh shtabi i brigadës. U hap lajmi se po vinte Karadaku, se ai kishte kryer një aksion në Gostimë: se kishte shumë shokë me vete etj. Brigada ndodhej në Popçisht. Me të marrë këtë lajm, komandanti i brigadës kapi mauzerin e qëlloi me të disa herë. Të shtënat morën dhenë. E gjithë brigada shtiu në shenjë gëzimi. Në ajër vezullonin plumbat me zjarr. «Erdhi Karadaku me shokë», këto fjalë shkonin gojë më gojë.

Dhe ja ku u duk Karadaku me pushkën e shkopin e gjatë alpin në dorë. Pas tij vinin shumë partizanë, që Karadaku i kishte mbledhur gjatë rragimeve. Ata ishin shkëputur duke qenë të sëmurë apo të ngrirë këmbësh dhe kishin mbetur nëpër male. Të prirë nga ai kishin ndjekur pas gjurmëve brigadën për më se një muaj. Gëzimi ishte i papërshkrueshëm. Takime, përqaftime. Nuk ishte një takim i thjeshtë. Për gati një muaj e kishin kujtuar për të vdekur. Dhe ja tani Karadaku ishte përsëri në mes të shokëve, i gjallë, i shkathët, i gatshëm për luftime të reja.

Pas takimit me shokët ai u paraqit te komandanti i brigadës, i cili e priste me padurim. Atij i tregoi për daljen nga rrethimi, për rragimet dhe rrugën që kishte ndjekur e aksionet që kishte kryer duke vijuar pas gjurmëve të brigadës.

DELEGAT NË KONGRESIN E PËRMETIT

Në muajin maj një ngjarje me rëndësi shumë të madhe historike e priste popullin shqiptar: do të mbahej Kongresi Antifashist Nacionalçlirimtar. Me gëzim të madh e pritën këtë lajm partizanët e partizanet e Brigadës I sulmuese, të cilët kishin dhënë kontributin e tyre me sulm e gjak për t'ja arritur asaj dite. Për të zgjedhur delegatët e kongresit, i cili do të hidhte bazat e shtetit të demokracisë popullore e do të kurorëzonte fitoren e shkëlqyer të vijës së partisë në Luftën nacionalçlirimtare, Brigada I u mbledh në Moglicë. Të gjithë ishin të gëzuar për fitoret e arritura dhe të gatshëm për beteja të tjera, edhe më të ashpra e të vështira.

Pas fjalimeve të rastit, që u mbajtën nga shokët me përgjegjësi të brigadës, filluar propozimet. I pari për të propozuar e mori fjalën komandanti i brigadës, shoku Mehmet Shehu.

Ai propozoi të parin për delegat në kongres Xheladin Beqirin, Karadakun.

Të gjithë partizanët e partizanet e pritën me një «Urra» të fortë, sa oshëtima vijoi të jehonte për disa minuta...

Delegatët u nisën. Ishte një grup i madh. Me delegatët ishin edhe të ftuar e grupi artistik i brigadës.



Partizanë e delegatë të Brigadës I S. në vigjilje të Kongresit të Përmetit. Midis tyre Heronjtë e Popullit Mehmet Shehu, Xheladin Beqiri (poshtë në të djathtë) dhe Fejzi Hysen Micoli (sipër në të majtë)

Në kongres Karadaku u takua e u shmalla me shokët e çetës, të cilët luftonin në brigada, grupe apo batalione të ndryshme. Një ditë, ndërsa po bisedonin, u afrua një partizan që në Tendën e Qypit kishte qenë plagosur rëndë dhe pat shpëtuar vetëm rastësisht. Secili, ndërsa e uronte për shërimin, i thoshte ndonjë shaka. Karadaku, që e kishte fjalën për operacionin që do të bëhej në drejtim të Veriut, tha:

— Mirë e bëre që u shërove. Prapë përtej Shkumbinit do të sulmojmë. Puna është të sulmojmë me vrull, që të mos e lëmë armikun të ngulë kund këmbët.

Edhe në Kongres Karadaku u ngarkua me detyrën e mbajtjes së rregullit e me sigurimin e drejtpërdrejtë të mbledhjes

Duke vlerësuar punën e tij si luftëtar besnik, në Kongres ju dha grada ushtarake kapiten i parë dhe në ato ditë u caktua komandant i batalionit të pestë të Brigadës I sulmuese.

KOMUNISTËT LUFTOJNË NË KËMBË

Me të mbaruar punimet Kongresi i Përmetit, më 27 maj 1944, Karadaku u kthye menjëherë në krye të detyrës, në batalionin e pestë të Brigadës I sulmuese.

Më 28 maj me forcat e Brigadës I, IV e V u formua Divizioni I i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, i cili e nisi jetën e tij me një luftë sa të përgjakshme, aq edhe heroike. Ai ja zbardhi faqen ushtrisë së popullit shqiptar, sepse u dha të kuptonin pushtuesve e tradhëtarëve se ushtria e popullit ishte e pathyeshme, se kushdo që do të përpiquej të nënshtronte vendet e çliuara me aq gjak e therrë do të merrte dënimin e merituar.

Armiku, i tronditur deri në palcë, meqë forcat partizane po e godisnin atje ku e quante veten më të sigurt, mendoi të organizonte një mësymje tjetër më të madhe e më të fortë se atë të dimrit. Për të arritur njëfarë përfundimi solli nga Greqia një divizion të tërë, të përforcuar me artileri, autoblanda e tanke, hoqi pjesën më të madhe të forcave që kishte në bregdetin shqiptar, mobilizoi e vuri përpara forcat bashibozuke: ballistë, zogistë e xhandarë. Me tërë këto hordhi, që arrinin mbi 45 mijë vetë, filloi mësymjen kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare

në drejtim të Skraparit, duke u nisur nga Leskoviku, Korça, Elbasani e Berati. Por ushtria e popullit nuk u përkul. Në çdo shkëmb e gërxhë të maleve shqiptare gjëmoi parreshtur pushka partizane.

Brigada I S. dhe një pjesë e Brigadës V S. ishin zënë në luftime shumë të ashpra e të përgjakshme në brigjet e lumit Devoll, në shpatet e vargmalit të Valamarës e deri në Tomorricë. Forcat gjermane mësynin nga Korça e Berati për të shpërthyer në drejtim të Skraparit.

Po zbardhte dita e 6 qershorit. Agimi i kuqërrremtë paralajmëronte ditë të nxehtë. Por në ato male kishte mjaft ditë që nuk digjte vetëm dielli. Me dhjetëra e dhjetëra topa e mortaja villnin zjarr nga grykat e tyre. Mijëra predha, duke fishkulluar stërkeqas, binin orë e çast shpateve. Gjëma e tyre tundte tokën, copat e çelikut të skuqur vringëllonin tej e mb'anë duke kërkuar viktimat nëpër llogore. Luftimet e filluara që në fund të majit ashpërsoshin çdo ditë e më shumë. E pikërisht atë ditë tendosja e forcave arriti kulmin. Pas sa e sa netëve pa gjumë e ditëve pa pushim, Karadaku, duke përfutuar nga heshtja e përkohshme, u mbështet te një lis të pushonte, të prehej pakëz, mbase të kapullonte një sy gjumë.

Por jo, nuk qe punë që bëhej! Pushka krisi e bile mu aty afër. Gjermanët sulmuan me forca të mëdha. Ai u çua, i ra bilbilit e, duke thirrë «Përpara, shokë partizanë!», me pushkë për faqe u hodh në kundërsulm. Pas tij të gjithë, si ndonjë lavë e zjarrtë, ju sulën në kokë armikut. Nazistët nuk i bënë dot ballë furisë partizane e u thyen. Por ata kishin ende forca. Hodhën në luftim trupat të fres-

këta. Partizanët, edhe pse të lodhur e të përgjakur, kundërsulmuan edhe më me vrull. Gjermanët u thyen e u zbrapsën për të dytën herë. Mirëpo këtu, që nga Qafa e Gjarpërit e deri në Gur të Prerë, vihej re një trusje e veçantë. Armiqtë u përpoqën për të çarë patjetër rrugë, ndërsa partizanët mbronin me çdo kusht këto pozita kyçe, sepse rënja e tyre shkaktonte copëtimin e forcave partizane. Aty nga mesdita armiku sulmoi për të tretën herë. Partizanët nuk qëndruan në mbrojtje. Ata u vërvitën në kundërsulm me vrull e heroizëm të pashoq. Përleshja u bë shumë e ashpër. Partizanët u pykëzuan thellë në rreshtat e armikut. Karadaku, ashtu si e kishte zakon, i pari u sul në këmbë atje ku ishte drejtimi i rrezikshëm, ku vendosej fati i suksesit të batalionit. Në përleshje trup me trup, kur po buzëqeshte fitorja e armëve partizane, një mitralier nazist, i struktur nën trugun e një lisi të rrëzuar, e qëllloi Karadakun. Sikur ishte, në ecje e sipër, ai ra përpara, në tokën e zhuritur nga zjarri, e, i larë rë gjak, mbylli sytë përgjithmonë, por dora e tij mbeti e mbyllur grusht e fytyra e qeshur, sikur donte të përshëndeste «Vdekje fashizmit», shokë!

Këtë çast me të vërtetë heroik e përjetësoi me këto vagje këngëtari popullor:

Në katër sulme me radhë

Bën kërdi Brigad e parë

Mos harroni Karadanë...

Trupin e tij pa jetë e muarën në krah një copë rrugë, sa e nxorën në qafë. Ishte mbasdite. Disa shtëllunga resh zunë diellin. Tokën e mbuluan ca

hije të zeza. Shpatet e gërxhet morën një dukje të zyrtë. Era e ngrohtë e pasdites fërshëllinte lehtë. Të zinin frymën: tymosja e barutit e duhma e gjakut. Tymi e pluhuri, që kishin mbuluar luginat, tani shtyheshin nga era e plogët e ngriheshin zvarrë shpateve e davaritëshin nëpër qafat e kreshtat. Majat e thinjura të maleve qëndronin krenare mbi krye. Dukej sikur ato sodisnin nga lart këtë përleshje titanike për jetë a vdekje midis luftëtarëve të Ushtrisë së lavdishme Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe hordhive të murrme barbare të pushtuesve nazistë gjermanë. Me madhështinë e tyre ato u jepnin zemër partizanëve, bijve dhe bijave të asaj toke, për të qëndruar si shkëmb e me gjoks, për të mbrojtur tokën amëtare, për t'u kallur datën armiqve pushtues.

Ndërsa lufta ziente me furi, një grup partizanësh hapnin një varr. Me sytë e tyre të skuqur e të përlotur shikonin herë gropën, herë kufomën e komandantit dëshmor. Karadaku rrinte shtrirë i ftohur, i lyer në gjak, i pazoti t'u printe, t'u thërriste «Përpara shokë, partizanë!» Ai tanimë nuk kishte frymë t'i binte bilbilit për sulm. Me duart e ashpra ata fshinin djersët e lotët dhe thellonin gropën e kobshme.

— Do të që më mirë sikur kjo e zezë gropë të hapej për mua e jo për komandantin tonë, për petritin Karadak. — tha njeri, një lab i thyer në moshë, dhe ofshani thellë. — Si ta kalbë toka këtë luan?

Por ja, trimin e vendosin në varr. Një batare pushkësh i dha përshëndetjen e fundit, lamtumirën e ndarjes përgjithmonë nga fusha e betejës, nga shokët e armëve, nga partizanët.

Karadaku ra dëshmor në Qafën e Gjarpërit më 6 qeshor 1944. Pikërisht atë ditë, pas dështimit të sa e sa sulmeve të njëpasnjëshme në disa drejtime, pushtuesit nazistë e panë qartë se kishin marrë të tatëpjetën. Që atë mbrëmje filluan aty-këtu të tërhiqeshin, herë me luftim e herë duke ikur. Forcat e Divizionit I S çanë përpara në të gjitha drejtimet e dolën në hapësirë gjithnjë e më të madhe operative.

Lajmi i rënjes së Karadakut u përhap si vetëtimë, jo vetëm midis partizanëve të Brigadës I S., por edhe midis gjithë efektivit të Divizionit I S.

Lidhur me këtë ngjarje në Buletinin e Divizionit I S të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shkruhej: «Në mbasdrekën e kësaj dite u zhvillua përpjekja më e rreptë në Qafë të Gjarpërit dhe te Guri i Prerë kundër armikut, që kërkonte të shkelte Tomoricën. Nga ana jonë morën pjesë në luftime dy batalionet IV dhe V të Brigadës I dhe batalionet I, III dhe V të Brigadës V. Edhe armiku kishte grumbulluar forca e mjete të shumta. Armiku filloi të sulmonte pasi rrahu vendin me artileri, por partizanët tanë u hodhën menjëherë në kundërsulm, aq sa u arrit edhe në përleshje trup me trup. . . Humbjet e armikut qenë jashtëzakonisht të rënda, por edhe tonat kanë qenë të ndjeshme. Nga ana jonë mbeti i vrarë komandanti i batalionit V të Brigadës I, komunisti Xheladin Beqiri (Karadaku)» 1).

Po, Xheladini luftoi si komunist e ra heroikisht, ashtu si binin komunistët, e mbajti lart këtë emër të shtrenjtë për të. Me shembullin e tij, me qëndri-

1) Buletini i lajmeve i Divizionit I të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Nr. 1, 1-15 qeshor 1944.

min e tij, me hovin e papërmbajtur në sulm, ai frymëzoi e mori krah vetes me dhjetëra partizanë, të cilët i fuste në luftim të rinj e të pastërvitur e i nxirrte që andej të pjekur, të matur, të aftë për të manovruar e për të dalë fitimtarë në sulme e luftime, sa të ashpra aq edhe të pabarabarta.

Nga gjiri i partizarëve u nda një komunist trim, një njeri i thjeshtë, i edukuar me virtytet e larta shqiptare dhe i brymosur me idealet e partisë. Më tepër se dy vjet Xheladini i kaloi nëpër zjarrin e luftës partizane, nëpër luftime të rrepta e të parrështura. Ai luftoi pa u epur, deri sa dha jetën për lirinë e atdheut, të popullit, për zbatimin e vijës së partisë. Shokët e tij e çuan deri në fund luftën për çështjen e madhe të revolucionit, për të cilën ai flijoi veten. Shembullin e tij e ndoqën e e ndjekin me gindra e mijëra komunistë shqiptarë.

Karadaku që një malësor i thjeshtë shqiptar, që njohu mjerimet e rendit shfrytëzues, që u rrit e u moshua nëpërmjet vuajtjesh e shtypjes së rëndë kombëtare e shoqërore. I etur për liri, ai qysh i ri e kishte provuar të rrokte pushkën e të luftonte, por nuk kishte gjetur prijës. Vetëm kur u ndriçua nga drita e mësimëve të partisë ai u ngrit e gjithë energjinë e tij, deri atëhere të heshtur, e vuri në shërbim të luftës për liri, për çlirimin kombëtar e shoqëror.

Të gjithë shokët e tij të çetës apo të brigadës ruajnë për të kujtimet më të mira. Ata e kujtojnë. Karadakun si një shok, si një malësor me tipare e virtyte burrërore thjesht shqiptare: trim e besnik, shpirtmadh e zemërgjerë, të thjeshtë, të urtë e me hov të pandalshëm revolucionar, të dashur me sho-

kët e popullin e të ashpër në luftë kundër armiqve të vendosur në zbatimin e përpiktë të vijës së partisë e të sigurt në arritjen e fitores, mospërfillës të vështirësive e të papërkulur dhe entuziast në kapërcimin e tyre.

I paharruar ka mbetur kujtimi i Karadakut në mendjen e zemrat e popullit të Kurveleshit, atje ku ai jetoi e luftoi krah për krah me kreshnikët e Labërisë. Atje e kujtojnë dhe e vajtojnë si djalin e tyre.

*Qani nëna e baballarë,
Qani për djemtë q'u vranë,
Në sulme përmbi gjermanë,
Mos harroni Karadanë,
Asim Zenel Progonanë.*

Karadakun, birin e Kosovës, nëna labe e qan bashkë me bijtë e saj më të shquar, nuk e ndan atë prej kryetrimave të Labërisë, heronjve të popullit Mustafa Matohiti e Asim Zeneli.

Në vajtimin e nënës labe Xheladini paraqitet ashtu si kishte qenë në të vërtetë jeta e tij plot brennga, punë e luftë:

*More Xheladin me halle,
Vish e xhvish ato gjerdane.
Ikët muartë ato male,
Ato male plot me borë
Dyfek e bomba në dorë.*

*Me Mustafa Matohinë
Xheladin, o trim i mirë,*

*U vrave për Shqipërinë,
Që të gëzojmë të lirë.*

Në Labëri jo vetëm e qajnë, por edhe i këndonë trimërisë së tij:

*Do marr pendën për të shkruar,
Do shkruaj me krenari,
Për ca shokë që u vranë
S'vijjnë më në Shqipëri.
Asim Zeneli i pari,
Mori malet për liri,
Vajti në çetën e parë,
Komisar u bë ai,
Me komandant Karadanë
Të dy trima me furi.*

Karadaku hyn në radhën e kryetrimave, e luftëtarëve të shquar të Luftës Nacionalçlirimtare. Jeta e tij i shërben brezit tonë të ri si shembull vendosmërie, heroizmi e vetëmohimi. Prej saj mësohet se si duhet dashur e mbrojtur atdheu ynë socialist e fitoret e revolucionit popullor. Ai është një ndër ata trima legjendarë të vegjëlisë, të lindur e të rritur në truallin shqiptar, të brumosur e të kalitur me mësimet e partisë, që do mbeten të paharruar ndër shekuj, si mbrojtës e pishtarë të pashuar të lirisë.

* * *

Kaluan 25 vjet që Xheladini nuk është më midis nesh. Një yll i artë shndrit në gjoksin e Avdiut. Ai na

simbolizon heroizmin e Xheladinit. Ky yll përjetëson nderimin që kishin luftëtarët e lirisë, partizanët e partizanet për Xheladinin. Presidiumi i Kuvendit Popullor të RP të Shqipërisë e miratoi këtë nderim me vlerësimin e veprës së Xheladinit, duke i dhënë atij titullin e lartë Hero i Popullit.

BIBLIOGRAFI

I. *Vepra të udhëheqësve të partisë e të shtetit*

1. Mehmet Shehu: Kujtime nga jeta e Brigadës I sulmuese, botim II, Tiranë, 1959.
2. Shefqet Peçi: Kujtime dhe dokumenta nga Lufta nacional-çlirimtare, vëll. I, Tiranë, 1968.

II. *Dokumenta arkivale*

1. Arkivi Qendror Historik i RPSH Tiranë.
2. Arkivi pranë Muzeut historik të Gjirokastrës

III. *Vepra historike, letrare e kujtime*

1. Ago Çeli: Në malet kryengritëse, Tiranë, 1966.
2. Andon Andoni: Heroi i Mezhgoranit, Tiranë.
3. Autorë të ndryshëm: Brigada I sulmuese e UNÇSH, Tiranë, 1963.
4. Behxhet Mema: Kujtime (dorëshkrim)
5. Ndreko Rino: Pëllëmbë e gjak, 1965.
6. Qamil Mane: Kujtime të një partizani, Tiranë, 1969.
7. Sotir Foto Andoni: Njëpër gjurmët e inkursionit të Brigadës I S pas 22 vjetësh (dorëshkrim)
8. Veledin Zeneli: Mustafa Matohiti, Tiranë 1966.
9. Xhafer Matuka: Ai ishte Tigri, Tiranë, 1969.
10. Xhelo Mato: Ata u kalitën ndër beteja, Tiranë, 1969.

IV. Revista

1. «Para në sulm». Viti I Nr. 2-3, mars-prill 1944
2. Studime historike. Viti XVIII (I), Nr. 4, 1964,
3. «10 Korriku», 1970, Nr. 1.


V. Gazeta

1. «Zëri i Popullit» Nr. 134, 6 qershor 1969.
2. «Zëri i Popullit» Nr. 281, 25 nëntor 1969.
3. «Zëri i Rinisë» Nr. 98 (2203) 6 dhjetor 1969

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Lexuesve.	3
Një nga të tetët	5
Nëpër dallgët e jetës	8
Nga njëri aksion në tjetrin	17
E ndoqën katër mbretëri	23
28 nëntor 1942	26
Komiti i vogël	28
Në çetën «Hajredin Tremishti»	31
Luftimi në Çorraj	38
Krah për krah me Asim Zenelin	40
Lamtumirë, hero	46
Nisja për në Vithkuq	52
Heto, zbuloi mandej sulmo	58
Luftëtar e punëtor	62
Sulmi i shpejtë të jep krah	66
Nga Patosi në Tendën e Qypit	68
Asgjë të mos i lëmë armikut	76
I rreptë, i dashur e i drejtë	78
Takimi në Bargullas	80
Shqiponjat fluturojnë maleve	83
Dikush lufton atje	85
Rravgimet pas Qarrishtës	90
Delegat në Kongresin e Përmetit	94
Komunistët luftojnë në këmbë	96
Bibliografi.	

56244



Tirazhi 9000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1971